

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2022

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME

Shkurt, 2023

PËRMBAJTJA

Shkurtime	3
Parathënie	4
Përmbledhje	7
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	15
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	15
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	15
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	15
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	16
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	16
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	18
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	22
1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve.....	24
1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK	26
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	28
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	28
1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë	28
1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë	28
1.5.1.2.1 Me AKUM (Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve)	28
1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës	29
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare.....	29
1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare.....	29
1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë.....	30
1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së.....	31
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	32
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	33
1.7.1 Të Ardhurat.....	33
1.7.2 Shpenzimet Operative	33
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2022	35
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	42
4 Reforma në Sektorin UK sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022	45
5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2023	48
6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2022	49
Investimet në Sektorin e Ujësllës Kanalizimeve.....	56
Subvencionet	57
7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	59
Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2022	60
Aneks 2 – Harta e ndarjes territoriale të shoqërive UK sipas reformës	62
Aneks 3 - Tarifat aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura, Viti 2022	63
Aneks 4 - Situata e ecurisë së reformës në vijim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 sipas hapave që duhen ndjekur	64
Aneks 5 - Subvencionet e Shoqërive UK, Vitet 2021-2022 (në lekë)	65
Aneks 6 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2022	66
Aneks 7 - Mbledhjet dhe Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator Viti 2022	67
Aneks 8 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së	69

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjetllës Kanalizime
U	Ujësjetllës
UN	Ujërat e Ndotura
FU	Furnizimi me Ujë
KUN	Kanalizimi i Ujërave të Ndotura
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
ERC	Rregullatori për Shërbimet e Ujit dhe Energjisë në Maqedoninë e Veriut
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
UPA	Uji Pa të Ardhura

Parathënie

Raporti Vjetor 2022 paraqet aktivitetin dhe performancën e Entit Rregullator të Ujit (ERRU) në përmbushje të detyrimit që e ngarkon ligji si dhe në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për ERRU-në për tu realizuar gjatë vitit 2022. Raporti pasqyron aktivitetin dhe performancën e këtij institucioni si dhe zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës të sektorit dhe të vetë institucionit.

ERRU, si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit UK, edhe gjatë vitit 2022 ka luajtur një rol aktiv gjithnjë e në rritje në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit duke rritur në mënyrë të vazhdueshme kërkesat ndaj shoqërive me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Viti 2022 konsiderohet si viti i fillimit të një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, e cila e agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale të krijuara si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) të regjistruara si shoqëri UK Rajonale, ndërkohë që sektori ka qenë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit.

Reforma mori formën e ligjore në maj 2022, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, *“Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”*.

Objektivi kryesor i procesit të reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Reforma konsiston në ndryshimin e statusit të shoqërive UK, të cilat do të organizohen si shoqëri aksionare me dy nivele administrimi. Asambleja e aksionarëve do të përbëhet nga qeveria qendrore MIE, e cila do të mbajë të paktën 51% të aksioneve dhe pjesa e mbetur prej 49% do llogaritet në raport me numrin e klientëve aktivë që kanë shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë Rajonale UK. Në vijim të reformës, deri në mbyllje të vitit 2022 janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale.

ERRU si një nga institucionet e ngarkuara nga VKM për zbatimin e reformës ka qenë mjaft aktive për të përmbushur detyrimet e tij të ngarkuara sipas ligjit nr.8102 dhe në mbështetje të ecurisë me sukses të realizimit të saj. Në këtë kontekst ERRU me anë të vendimit të KKRR Nr.420, datë 29.09.2022 *“Për licencat dhe tarifave të shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta”*, ka lehtësuar ecurinë e këtij procesi duke i dhënë shoqërive UK ***të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta (SKP-UK) si dhe duke i lejuar shoqëritë SKP-UK të përdorin tarifave aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU, deri në miratimin e tyre, nga Komisioni Kombëtar Rregullator.***

Aktiviteti i ERRU-së edhe për vitin 2022 ka vijuar në disa nga drejtimet kryesore të mëposhtme si:

- Licencimi i Shoqërive UK;
- Miratim i Tarifave të reja të propozuara nga Shoqëritë UK;
- Monitorimi i Performancës së Shoqërive UK;

- Mbrojtja dhe Trajtim i Ankesave të Konsumatorëve;
- Pjesëmarrje në Konferenca në nivel institucional kombëtar dhe ndërkombëtar si fizike ashtu dhe përmes platformave online;
- Raportime dhe Analiza mbi Aktivitetin e ERRU-së, etj.

Në funksion të drejtimeve kryesore të mësipërme, ERRU gjatë vitit 2022 ka marrë në shqyrtim dhe ka miratuar licencat për 17 shoqëri UK nga të cilat 15 shoqëri UK (shoqëritë ekzistuese) dhe 2(dy) shoqëri UK Rajonale të krijuara sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022, përkatësisht UK Korçë SKP dhe UK Lezhë SKP.

Gjithashtu ERRU, ka analizuar aplikimet për nivel të ri tarifor dhe ka miratuar vendimet përkatëse për pesë shoqëri UK, përkatësisht UK Bulqizë, Kukës, Konispol, Elbasan dhe UK Durrës. Kjo e fundit ka aplikuar vetëm për miratimin e tarifave të shitjes së ujit me shumicë për shoqëritë UK Kurbin dhe UK Vorë, pasi klientët e këtyre zonave, sipas reformës në kuadër të krijimit të shoqërisë rajonale UK Durrës SPK, nuk i përkasin më zonës së saj të mëparshme të shërbimit. Vendimet e miratimit të tarifave në çdo rast janë shoqëruar me vendosjen e objektivave për tu arritur nga shoqëritë UK në të ardhmen në drejtim të përmirësimit të treguesve kryesorë të performancës si dhe të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve kur këto shoqëri do të jenë pjesë e shoqërive rajonale përkatëse.

Monitorimi i performancës në terren i shoqërive UK, ka vijuar të jetë në fokus kryesorë edhe për vitin 2022. Kjo është reflektuar edhe në numrin e lartë të monitorimeve të zhvilluara në 26 shoqëri UK, me qëllim nxitjen e përmirësimit të performancës së shoqërive UK dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Saktësia e të dhënave të raportuara mbetet sfidë për shoqëritë UK, pasi ato janë elementi bazë i një analize objektive të performancës së shoqërive, si dhe për vendosjen e objektivave nga ERRU për përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen.

Gjatë vitit 2022, një vëmendje e shtuar i është kushtuar nga ERRU edhe mbrojtjes së konsumatorëve, ku përveç zgjidhjes së ankesave ndërmjet tyre dhe shoqërive UK, është lançuar edhe mekanizmi më i ri i pranimit të ankesave të konsumatorëve, sistemi online nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së, **www.erru.al**. Gjithashtu, ERRU, ka kontribuar si anëtare e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik" të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, ka vijuar të jetë në fokus të ERRU-së edhe gjatë vitit 2022, si me Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM në kuadër edhe të reformës, si dhe me Autoritetin e Konkurrencës në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Viti 2022 ka patur një rëndësi të veçantë edhe në drejtim të bashkëpunimeve dhe marrëdhënieve bilaterale në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe të cilësisë së aktivitetit të ERRU-së. Ngjarja më e rëndësishme në këtë drejtim cilësohet nënshkrimi Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet katër rregullatorëve të sektorit të ujërave në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht, Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni duke e çuar në një tjetër nivel marrëdhënien e bashkëpunimit rajonal për të adresuar sfidat e përbashkëta në fushën e ujësjellës kanalizimeve, shkëmbimin e eksperiencave pozitive si dhe avancimin e procesit në përafrimin e legjislacionit të BE-së për ujin. Marrëveshja u cilësua si një moment historik dhe e një rëndësie të veçantë për forcimin e bashkëpunimit me përfitime ekonomike

dhe mjedisore edhe nga presidenti i WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit) dhe Zv. Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilët ishin prezent në nënshkrimin e saj. Një tjetër Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua edhe me Rregullatorin e Hungarisë, e cila synon bashkëpunimin midis dy autoriteteve duke transferuar njohuritë dhe përvojat më të mira për përmirësimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve për liçensimin dhe tarifat e shërbimeve.

Gjithashtu, ERRU, ka vijuar bashkëpunimin me WAREG, ku ERRU është anëtare me të drejta të plota, Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), UNECE (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën), Komisionin Evropian, me shoqatat e ujësjellësve të Shqipërisë dhe Kosovës SHUKALB dhe SHUKOS.

Pjesë e këtij Raporti është edhe performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2022, përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës së sektorit në të ardhmen.

Gjendja e sektorit UK për vitin 2022, e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës krahasuar me vitin e mëparshëm, tregon një performancë të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit, me përjashtim të treguesit financiar Mbulimi i Kostove O&M, i cili ka një rënie të ndjeshme me 12.9%.

Shoqëritë UK, në përgjithësi kanë punuar mirë në disa aspekte të menaxhimit, si ulja e sasisë së ujit të prodhuar, rritja e faturimit, përmirësim të arkëtimeve korrente dhe të prapambetura si dhe në uljen e numrit të konsumatorëve pa matës, por performanca financiare është përkeqësuar. Kjo ka ardhur si rezultat i krizës globale të energjisë elektrike, pasi kostoja e energjisë përbën pjesën kryesore të kostove O&M të sektorit. Konstatohet se 70% e rritjes së kostove të O&M ka ardhur si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike i cili në vitin 2022 është rritur me rreth 65%.

Për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet dhe të merren masa për rritjen e Efiçencës së Energjisë dhe burimeve alternative të rinovueshme, si sfida kryesore për sektorin UK edhe për vitin në vijim.

ERRU, në përmbushje të detyrimeve ligjore kundrejt sektorit UK dhe konsumatorëve, do të vazhdojë të rrisë angazhimin e tij për të forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimeve, politikëbërësve dhe konsumatorëve.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

Raporti Vjetor 2022 i Aktivitetit të ERRU-së Instrument Informimi dhe Transparence

Hartimi dhe publikimi i Raportit Vjetor 2022 të aktivitetit të ERRU-së paraqet veprimtarinë e këtij institucioni dhe përmbush detyrimin ligjor në zbatim të ligjit nr.8102, me qëllim informimin dhe transparencën ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrisë, si dhe institucioneve apo aktorëve të tjerë që lidhen me sektorin e ujit mbi aktivitetin e ERRU-së. Misioni i ERRU-së është "Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të FU dhe KUN ti ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme".

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetin e ERRU-së në përmbushje të misionit të mësipërm, si dhe objektivat e punës së ERRU-së në të ardhmen në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur. Gjithashtu në kapituj të veçantë jepen detaje mbi ecurinë e reformës në sektorin UK, si dhe analizohet gjendja e performancës së sektorit të ujit, ku jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen.

ERRU, Statusi Ligjor, Përgjegjësitë dhe Struktura Organizative

ERRU, si institucion i pavarur ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Ky ligj e ngarkon ERRU-në me përgjegjësitë e:

- Licencimit;
- vendosjes së tarifave të shërbimeve UK;
- mbrojtjes së interesave të konsumatorëve nga natyra monopol e këtyre shërbimeve, ku shoqëritë UK mund të abuzojnë duke ofruar tarifa të larta dhe shërbime jo cilësore.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas Vendimit nr. 33 të vitit 2022 me 29 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë komisioni, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Gjatë vitit 2022, në vijim të aktivitetit ekzekutiv gjithnjë në rritje të ERRU-së në sektor, u realizua plotësimi i organikës aktuale me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm pas miratimit të saj nga Kuvendi.

Në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së, është i nevojshëm rishikimi në disa drejtime të ligjit aktual nr. 8102 për rregullatorin.

Licencimi i Shoqërive UK

Gjatë vitit 2022, qeveria qendrore, me vendimin nr.302, datë 11.05.2022, mori nismën për agregimin e shoqërive UK i cili parashikon riorganizimin e sektorit nga 58 shoqëri UK ekzistuese në 15 shoqëri Rajonale UK.

Pranë Enti Rregullator të Ujit gjatë vitit 2022 kanë paraqitur dokumentacionin për licencim 20 shoqëri UK, nga të cilat 17 për rilicensim si shoqëri të paagreguara dhe 3 të riorganizuara si Shoqëri UK Rajonale. Enti Rregullator i Ujit ka miratuar licencat për 17 shoqëri UK nga të cilat 15 shoqëri UK të riorganizuara sipas VKM nr.63, datë 27.01.2016 (shoqëritë ekzistuese) dhe 2(dy) Shoqëri UK Rajonale, përkatësisht UK Korçë dhe UK Lezhë, ndërsa shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a nuk arriti të pajiset me licencë nga ERRU brenda vitit 2022, për mungesë dokumentacioni dhe pritet licencimi i saj në fillim të vitit 2023.

Deri në fund të vitit 2022 mbeten 9 shoqëri UK pa licencë, konkretisht UK Tropojë, Klos, Rrogozhinë, Patos, Divjakë, Pustec, Përmet, Dropull dhe Libohovë, të cilat pritet të aplikojnë për licencim në përbërje të shoqërive të reja rajonale.

**Procesi i
Miratimit të
Tarifave për
Shërbimet UK**

Gjatë vitit 2022, ERRU, ka shqyrtuar dhe ka marrë vendimet përfundimtare për tarifa të reja për 5 shoqëri UK, përkatësisht UK Kukës, UK Konispol, UK Bulqizë, UK Durrës dhe UK Elbasan.

UK Bulqizë ka aplikuar në shtator 2021 pas një periudhe 10 vjeçare, për tarifa të unifikuara për të gjithë zonën e shërbimit. Me tarifën e reja të miratuara synohet mbulimi 100% i kostove operative dhe amortizimit vjetor, si dhe respektimi i mbajtjes dhe raportimit të të dhënave sipas kërkesave të ERRU-së.

UK Kukës ka aplikuar në Tetor 2021 për tarifa të reja për të gjithë zonën e shërbimit, duke përfshirë për herë të parë dhe tarifën fikse. Tarifën e reja të miratuara synojnë mbulimin 100% të kostove operative dhe 84% të kostove totale, me fokus kryesor përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit për rritjen e kapaciteteve të likuiditeteve të shoqërisë.

UK Konispol ka aplikuar për herë të parë pasi u licencua në dhjetor 2021, për të miratuar tarifën volumetrike vetëm për shërbimin e FU, pasi nuk ofron shërbim të KUN. Me tarifën e reja përmbushet kushti ligjor që shoqëria duhet të operojë me tarifa të rregulluara dhe miratuara nga ERRU.

UK Durrës ka aplikuar në Qershor 2022, për të miratuar vetëm tarifën e shitjes së ujit me shumicë për UK Kurbin dhe UK Vorë, pasi pas krijimit të shoqërisë rajonale UK Durrës klientët e këtyre zonave nuk do të jenë më pjesë e zonës së saj të shërbimit.

UK Elbasan ka aplikuar në qershor 2022, për të miratuar tarifa të unifikuara për të gjithë zonën, pasi është bashkuar me Elbasanin fshat që më parë ka qenë shoqëri më vete, me synimin e rritjes së qëndrueshmërisë të gjendjes financiare të shoqërisë, duke mbuluar edhe kostot e energjisë elektrike pas rritjes së çmimit të energjisë nga ERE.

**Monitorimi i
Performancës
së Shoqërive
UK**

Viti 2022 është karakterizuar nga ndryshime thelbësore në sektor si rezultat i reformës të miratuar nga qeveria qendrore në maj të këtij viti. ERRU ka vazhduar monitorimin e sektorit UK duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga shoqëritë UK, përfshirë vizitat dhe monitorimin në terren të tyre. Gjatë vitit 2022 ekipet nga ERRU kanë realizuar vizita në terren në 26 shoqëri. Kryesisht monitorimet janë realizuar pranë shoqërive UK të cilat janë vlerësuar se kanë raportuar të dhëna të dyshimta që kanë patur nevojë për verifikime të mëtejshme në terren, përkatësisht në shoqëritë *UK Kavajë, Vorë, Peqin, Divjakë, Cërrik, Belsh, Fushë Arrëz, Përmet, Memaliaj, Këlcyrë, Kukës, Lushnje, Tropojë, Erseke, Vau Dejës, Poliçan, Ura Vajgurore, Konispol, Delvine, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Bulqizë, Dibër, Libohovë, Finiq, Kamëz dhe Krujë*.

Saktësia e të dhënave vijon të mbetet një nga problematikat kryesore që ka sektori UK sidomos mbas zbatimit të reformës, e cila kërkon rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë nga ana e stafeve drejtuese të shoqërive UK dhe të vëmendjes dhe kontrollit nga ana e ERRU-së ndaj tyre.

**Mbrojtja dhe
Trajtimi i
Ankesave të
Konsumatorëve**

Në vijim të krijimit të Strukturës së Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM) si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK, gjatë vitit 2022 është shtuar kontributi i ERRU-së si anëtare e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik" të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Kjo, ka sjellë një qasje më afër konsumatorit, jo vetëm në mënyrën e zgjidhjes së ankesave, por edhe të krijimit të mekanizmave lehtësuese dhe efikase në trajtimin e ankesave të tyre.

Gjatë vitit 2022, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit janë depozituar 10 ankesa të ardhura si nga konsumatorë familjarë, privat dhe institucione publike nga të cilat 5 prej tyre kanë marrë zgjidhje përfundimtare në favor të konsumatorit. Natyra e ankesave vijon të jetë në tre kategori zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime, cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK dhe faturimi aforfe. Trajtimi i ankesave sipas natyrës së problematikave, përveç takimeve të drejtpërdrejta me shoqëritë UK, janë trajtuar edhe me verifikime në terren. Në kuadër të edukimit të konsumatorëve dhe shoqërive UK për rolin ndërmjetësues që ka ERRU për trajtimin e ankesave, orientimi dhe trajtimi i disa prej ankesave është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, gjatë këtij viti është lançuar edhe mekanizmi më i ri i pranimit të ankesave të konsumatorëve, sistemi online nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al. Ky sistem online, ndërgjegjësimi i konsumatorit për të drejtat e tij dhe mekanizmat efektive që i ofrohen për të drejtuar ankesat, do të jenë pjesë e një fushate sensibilizuese që do të ndërmarrë ERRU për vitin e ardhshëm.

Reforma në Sektorin UK sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022

Viti 2022 shënoi një hap të rëndësishëm për sektorin UK në drejtim të reformimit me anë të agregimit të tij. Në maj 2022, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 302, *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”* i cili parashikon riorganizimin e sektorit nga 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë në 61 bashki të vendit në 15 Shoqëri UK Rajonale. **Objektivi kryesor i këtij procesi është rritja e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve UK dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit.**

Reforma në mënyrë të përmbledhur konsiston si më poshtë:

- Riorganizimin e shoqërive UK si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKP-UK) si 15 shoqëri rajonale aksionare me dy nivele administrimi.
- SKP-UK-ja e themeluar do të ketë në asamblenë e aksionarëve përfaqësues të qeverisë qendrore MIE, e cila do të mbajë 51% të aksioneve. Pjesa e mbetur prej 49% do llogaritet në raport me numrin e klientëve aktivë që kanë shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë rajonale UK.
- SKP-UK-të e krijuara janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktuale, kontratat e shërbimeve, si dhe çdo të drejtë që rrjedhin prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ish-njësive të qeverisjes vendore, me institucionet financiare ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese.
- SKP-UK-të e krijuara nga riorganizimi, brenda tre muajve nga miratimi i Prefektit të Qarkut, do të aplikojnë për marrjen e licencës së re për ofrimin e shërbimeve UK nga ERRU.
- Transferimi i aktivitetit do të bazohet në një kontratë të noterizuar që do të nënshkruhet ndërmjet palëve e cila do të regjistrohet në pasqyrat financiare të Shoqërive të reja.

Deri në fund të vitit 2022 janë arritur marrëveshjet e transferimit të aktivitetit të shërbimeve UK ndërmjet 50 bashkive dhe si rrjedhojë janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës. Shoqëritë e reja Rajonale të krijuara janë **UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Dibër, UK Kukës, UK Berat, UK Elbasan, UK Gjirokastër, UK Fier, UK Lushnjë dhe UK Sarandë.**

Mbeten akoma 11 bashki të cilat sipas parashikimeve të reformës në sektor përbëjnë 3 shoqëri UK Rajonale përkatësisht **UK Shkodër** me bashkitë (Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë) **UK Tiranë** me bashkitë (Tiranë, Kamëz, Vorë) dhe **UK Vlorë** me bashkitë (Vlorë, Selenicë, Himarë). Nga ana e këshillave bashkiake janë marrë vendimet përkatëse për autorizimin e kryetarëve të bashkive për nënshkrim e marrëveshjeve me MIE/AKUM dhe për të vijuar më tej me marrëveshjen e transferimit të aktivitetit, por si rezultat i pikëpamjeve të ndryshme nga ana e drejtuesve të pushteteve vendore në aspektin manaxherial të shoqërive UK, palët janë akoma në diskutim të marrëveshjes përfundimtare.

ERRU, në vijim të reformës dhe hapave që duhen ndjekur për konkretizimin e saj, ka luajtur një rol proaktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtim të licencave dhe tarifave të cilat i shërbejnë përsheptimit dhe ecurisë së këtij procesi. KKRR me vendimin Nr. 420, datë, 29.09.2022 *“Për licencat dhe tarifave të shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”*, ka lehtësuar ecurinë e këtij procesi duke i dhënë shoqërive UK **të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në SKP si dhe duke i lejuar shoqëritë SKP-UK të përdorin tarifave aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU, deri në miratimin e tyre nga ERRU**. ERRU, ka zhvilluar një sërë takimesh me drejtuesit e rinj të shoqërive UK Rajonale të krijuara, me qëllim diskutimin e pengesave të ndryshme që hasen për zbatimin e reformës gjatë periudhës tranzitore, si dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre duke patur parasysh respektimin e kërkesave në zbatim të ligjit të ERRU-së nr. 8102 për problemet e licencimit dhe të tarifave të shërbimeve.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore të përcaktuara në kontratat me Shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Të ardhurat totale nga veprimtaria gjatë vitit 2022 janë 54, 456, 988 lekë përbërë nga:

- Pagesat rregullatore vjetore 2022 referuar kontratave në fuqi me shoqëritë UK në vlerë 53, 676, 988 lekë;
- Licencimet e reja dhe rinovimet e licencave të shoqërive UK gjatë vitit në vlerë 780, 000 lekë.

Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2022, janë realizuar në shumën 47, 924, 224 lekë nga 53, 154, 530 lekë të planifikuara për t’u shpenzuar gjatë vitit.

Në mbyllje të vitit 2022, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU-së garanton plotësisht realizmin e parashikimit të planit të shpenzimeve të vitit 2023.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU monitoron dhe analizon vazhdimisht gjendjen dhe performancën e sektorit UK. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës të miratuar nga ERRU. Për vitin 2022 janë shtuar dy tregues të rinj performance, **“Efiçenca e Energjisë”** dhe **“Ankesat e Klientëve”**. Situata e treguesve të performancës për vitin 2022 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2021 jepet në Tabelën nr.1.

Tabela nr.1. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2021-2022

Nr.	Treguesit Kryesore te Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2021	Viti 2022	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	64.8	63.4	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	103.4	90.5	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	77.6	78.6	↗
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	92.3	94.7	↗
5	Niveli i Matjes	%	80.7	82.8	↗
6	Efiçenca e Stafit	(stafi/1000 lidhje UK)	4.9	4.66	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	15.4	16.3	↗
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.8	78	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	52	54.4	↗
10	Efiçenca e Energjisë FU*	Kwh/m³	n/a	0.69	-
11	Ankesat e Klientëve*	%	n/a	2.92	-

Burimi: ERRU

** Tregues të vendosur për tu marrë në analizë për herë të parë gjatë vitit 2022.*

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2022 paraqiten të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesit financiar, Mbulimi i Kostove O&M, i cili ka një rënie të ndjeshme me 12.9% pavarësisht se ka një përmirësim të treguesve të Normës të Arkëtimit Korrente dhe të Përgjithshme. Faktori kryesor në përkeqësimin e mbulimit të kostove O&M është rritja e çmimit të energjisë elektrike me rreth 65% krahasuar me një vit më parë.

Treguesit e përmirësuar për vitin 2022 si ato të Nivelit të Matjes, Mbulimi me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, kanë dhënë një impakt mjaft pozitiv në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

Për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet dhe të merren masa për rritjen e Efiçencës së Energjisë dhe burimeve alternative të rinovueshme, si sfida kryesore për sektorin UK edhe për vitin në vijim.

Në mënyrë të përmbledhur jepet analiza e ecurisë për secilin tregues kryesor të performancës.

"Uji Pa të Ardhura" për vitin 2022 është përmirësuar me rreth 1.4% krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së volumit të ujit të faturuar me 2.7 milion m³, si dhe uljes së volumit të prodhuar me 11.3 milion m³. Ndikim kryesorë kanë dhënë shoqëritë *UK Tiranë dhe UK Kavajë* me një rritje të volumit të ujit të faturuar me rreth 2 milion m³. Ulje të sasisë së ujit të prodhuar janë shënuar për shoqëritë *UK Tiranë, Berat - Kuçovë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Mallakastër*. Gjithsesi, për vitin 2022 edhe pse i përmirësuar, ky tregues mbetet përsëri në nivele të larta, 63.4%.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" për vitin 2022, ka rënë ndjeshëm nga 103.4% në 90.5%, kjo për shkak të krizës energjitike dhe të rritjes së çmimeve në përgjithësi. Gjatë vitit 2022, nga 58 shoqëri që operojnë në sektor, vetëm 13 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M nga 12 që ishin në vitin 2021. Veçanërisht 26 shoqëri performojnë dobët nën nivelin 70% të këtij treguesi.

"Norma e Arkëtimit" Normën e Arkëtimit Korrente, e cila përfaqëson arkëtimet e kryera nga shoqëria brenda vitit pa përfshirë debitë e vjetra, për vitin 2022 rezulton të jetë përmirësuar në 78.6% nga 77.6% që ishte në vitin 2021. Performancë të mirë kanë realizuar shoqëritë *UK Librazhd, Tepelenë, Dibër, Fushë Arrëz, Delvinë, Dropull, Ersekë, Has, Durrës, Vlorë dhe Tiranë*.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme, që përfshin edhe arkëtimet e debive të vjetra është përmirësuar në 94.7% nga 92.3% në vitin 2021. Shoqëritë me performancë

të përmirësuar për këtë tregues janë, *UK Vau Dejës, UK Gjirokastrë, UK Himarë, etj.*

"Niveli i Matjes" është në nivelin 82,8% duke u përmirësuar me 2.1% krahasuar me vitin 2021. Gjatë vitit 2022, në total janë instaluar rreth 23, 601 matës uji, por ende raportohen 162,421 klientë pa matës nga të cilët 6,618 janë të kategorisë jo familjarë. Shoqëritë UK, duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, pasi faturimi aforfe favorizon shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje etj.

"Eficienca e Stafit". Treguesi i efijencës së stafit për vitin 2022, ka një përmirësim të lehtë dhe rezulton në nivelin e 4.66 punonjës për 1000 lidhje UK nga 4.9 që ishte në vitin paraardhës. Përmirësimi ka ardhur si rezultat i lidhjeve të reja të ujit me rreth 23, 601 lidhje dhe atyre me kanalizime me rreth 14,778, ndërkohë numri i stafit në total për sektorin është reduktuar me 88 punonjës. Për shumë shoqëri ky tregues mbetet artificialisht i lartë për shkak të garantimit të sigurisë së veprave të ujit me personel roje në numër të lartë, sidomos në ato sisteme ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh dhe që krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Efijencës së Stafit. Gjithashtu evident mbetet edhe abuzimi me punësimet e pajustificuara mbi nevojat e shoqërisë.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" e cila shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë, për vitin 2022 është në nivelin e 16.3 orë/ditë me një përmirësim prej rreth 1 orë krahasuar me vitin 2021. Në mbyllje të vitit, rezulton se në sektor operojnë 11 shoqëri UK që kanë furnizim të pandërprerë 24/7 ndërsa pjesa dominuese e shoqërive rreth 33 prej tyre ofrojnë furnizimin me ujë në nivele relativisht të mira 10-22 orë në ditë. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e kryera në sektor, ku rritja e orëve të furnizimit me ujë 24/7 është edhe objektiv afatshkurtër i qeverisë qendrore 2018-2023, projekt që fillimisht ka filluar me qendrat urbane, ku synohet furnizim me ujë 24/7 për 58 nga 66 qendra urbane, deri në fund të vitit 2023.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2022 ka një përmirësim me rreth 1.2% dhe është në nivelin e 78% nga 76.8% që ishte në vitin 2021. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i shtimit të popullsisë së juridiksionit me vetëm 4,212 banorë ndërsa ajo e shërbyer me rreth 57,052 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë *UK Tiranë, UK Durrës UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë dhe UK Kavajë.*

"Mbulimi me Kanalizime" për vitin 2022 ka një përmirësim me rreth me 2.4% krahasuar me vitin 2021 dhe paraqitet në nivelin e 54.4%, kjo pasi popullsia me shërbimin e KUN është rritur me rreth 103,153 banorë. Në sektor janë akoma rreth 78 mijë banorë të cilët e realizojnë grumbullimin e UN nëpërmjet gropave septike. Gjatë vitit 2022 është raportuar një rritje me 22,170 banorë e popullsisë së shërbyer me ITUN krahasuar me vitin 2021. Gjithsesi, ky tregues vijon të mbetet në nivele të ulëta, kjo pasi ndër vite investimet kanë qenë fokusuar në drejtim të mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë.

"Eficienca e Energjisë" referuar metodologjisë së re të tarifave, ky tregues konsiderohet për herë të parë, i cili merr një vëmendje të veçantë edhe në përgjigje të krizës globale të energjisë elektrike. Për vitin 2022 efijenca e energjisë për furnizimin me ujë në sektor është 0.69 kwh/m³. Tendenca e këtij treguesi do të jepet vitin tjetër duke e krahasuar me atë të vitit 2022. ERRU, ka vendosur edhe detyra për studimin e efijencës së energjisë për shoqëritë që kanë aplikuar për tarifa gjatë vitit 2022.

"Ankesat e Klientëve" Gjithashtu referuar metodologjisë së re të tarifave, ky tregues konsiderohet për herë të parë si tregues i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe në mbrojtje të interesave të tyre.

Ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2022 janë 2.92%, por për arsye krahasimore me vitin paraardhës ky tregues nuk do të merret në analizë për këtë vit.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2023**

- Të jetë proaktive duke ndjekur nga afër procesin e riorganizimit të sektorit sipas parashikimeve të reformës në mbështetje të realizimit të objektivave përkatëse për realizimin e saj dhe për përmirësimin e performancës së sektorit duke dhënë kontributin e tij në zbatim të VKM nr.302 dhe ligjit funksional të ERRU-së nr.8102.
- Duke qenë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur nga MIE sipas urdhrit nr. 165, datë 08.09.2022 për “Hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri”, të ndikojë në rishikimin e ligjit nr. 8102 duke patur parasysh forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.
- Të angazhohet në nxitjen direkte për licencimin sa më parë të të gjitha shoqërive UK Rajonale të krijuara bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përfshirë dhe situatën e licencimit për shoqëritë UK Ekzistuese që mbeten pa u riorganizuar sipas VKM nr.302 datë 11.05.2022.
- Të ofrojë asistencën e duhur për shoqëritë rajonale në lidhje me problematikat që në mjaft raste priten të hasen nga propozimet e tarifave të reja duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.
- Të shtojë vëmendjen dhe kontrollin ndaj shoqërive UK për rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave si një ndër problematikat kryesore të sektorit, si dhe në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm në terren të shoqërive UK Rajonale dhe atyre të pa agreguara me qëllim nxitjen e tyre për arritjen e treguesve kryesorë të performancës.
- Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK mbi procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime për t’u realizuar nga ato.
- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me rregullatorët e Ballkanit Perëndimor, Evropianë WAREG dhe veçanërisht me Rregullatorin e Italisë ARERA dhe Hungarisë MEHK, të shfrytëzojë mundësitë e rritjes profesionale të stafit përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave me to dhe ato bashkëkohore.
- Të vijojë të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit, veçanërisht Shoqatën e Shoqërive UK, SHUKALB në mbështetje të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.

- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të “Acquis Communautaire” të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN.

**Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës
së Sektorit UK
dhe të ERRU-së**

- Në vijim të vendimit të qeverisë qendrore nr.302, datë 11.05.2022 mbi agregimin e sektorit nga 58 shoqëri UK në 15 shoqëri SKP-UK Rajonale, të intensifikohen përpjekjet për përfundimin e agregimit të sektorit me mbështetjen e duhur institucionale, financiare dhe me asistencë për shoqëritë që akoma nuk janë agreguar.
- Të vijohet sa më parë nga AKUM me një analizë më të thelluar me mbështetje të asistencës edhe të donatorëve në lidhje me hartimin e Planeve 5 Vjeçare të Biznesit për shoqëritë UK të reja rajonale, në të cilat përcaktohen objektivat, nevojat për investime, si dhe dinamika e tarifave drejt mundësisë së unifikimit të tyre për zonën rajonale të shërbimit.
- Nisur nga problematika e kostove të energjisë që aktualisht zënë rreth 50% të kostove operative të sektorit, të realizohet sa më shpejt një analizë “due diligence” për sektorin për strategjinë e çmimeve të energjisë elektrike për sektorin UK në drejtim të mundësisë së pagesës së faturës së energjisë elektrike nga shoqëritë rajonale UK dhe ato të paagreguara duke marrë parasysh kriterin e përballueshmërisë së pagesës së faturës së ujit nga konsumatorët dhe/ose subvencionimin e tyre.
- Në përgjigje të krizës aktuale globale energjitike dhe të elementeve të pasigurisë edhe për vendin tonë, të shihet si prioritet hartimi i Planeve të Rritjes së Efiçencës së Energjisë për shoqëritë UK, fillimi sa më shpejt i zbatimit të konkluzioneve të tyre, si dhe financimit të nevojave që ato parashikojnë si domosdoshmëri për rritjen e efiçencës së energjisë elektrike.
- Të planifikohen dhe alokohen fondet përkatëse për pajisjen e të gjithë sistemeve të furnizimit me ujë, me ujëmatës të mëdhenj në Burim, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e hartimit të saktë të Bilanceve të Ujit duke njohur kështu gjendjen reale të kërkesës për ujë, si dhe nevojën për uljen e humbjeve fizike dhe administrative në sistemet e furnizimit me ujë.
- Duke qenë se qeveria qendrore është aksionare e shumicës në të gjitha shoqëritë rajonale UK, duhet të evidentohet më qartë dhe të forcohet roli i ERRU si institucion i pavarur për të monitoruar sektorin UK në mënyrë që vlerësimi i performancës së tij të realizohet në mënyrë sa më transparente dhe objektive për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e performancës, të problematikave, si edhe të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tij.
- Duke qenë se investimet fizike janë të lidhura ngushtë me tarifat e shërbimeve dhe të cilësisë së shërbimeve UK, duhet të krijohet mundësia e përfshirjes së Rregullatorit (ERRU) në komisionet ad-hoc edhe ato teknike në MIE/AKUM të shqyrtimit të nevojës për investime në sektor, si dhe të vlerësimit të projekteve përkatëse të tyre.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është një institucion i pavarur publik, i cili rregullon sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. ERRU është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, i cili ka si qëllim kryesor mbrojtjen e interesave publike krijimin e një mjedisi transparent dhe ligjor në sektorin e FU dhe KUN, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tij.

Përgjegjësitë kryesore të ERRU janë licencimi i shoqërive që veprojnë në sektor dhe miratimi i tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për të gjitha kategoritë e klientëve. Ndër të tjera, ERRU ka përgjegjësi të monitorojë gjendjen e sektorit dhe të shoqërive në veçanti dhe të hartojë raporte me të cilat informon Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe publikun.

Një tjetër përgjegjësi e ERRU është marrja e masave administrative ndaj shoqërive që veprojnë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 8102 dhe kushteve të licencës së operimit.

Gjithsesi në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së është i nevojshëm rishikimi në disa drejtime i ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN", që do konsolidojnë më tej rolin e tij në drejtim të rregullimit dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të sektorit, përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, ngritjes së kapaciteteve si institucion, si dhe kontributit në përmbushje të kërkesave të "acquis communautaire" për Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, KUN dhe llumrave të ITUN që rrjedhin nga statusi aktual i hapjes së negociatave për anëtar i Bashkimit Evropian.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të "Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë"

ERRU, nuk është subjekt i detyrimeve ndërkombëtare, si dhe i rekomandimeve të "Progres-Raportit për Shqipërinë" që duhen përmbushur prej saj.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Forma organizative, struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj". Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë, miratohen me vendim të Kuvendit. Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 33/2022, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me

Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Me miratimin e kësaj strukture, për Entin u mundësua realizimi i përmirësimeve dhe ndryshimeve të nevojshme në kuadër të ristrukturimit të sektorit UK. Ndryshimi gjithashtu erdhi edhe si përpjekje e ERRU-së për përmirësimin e kapaciteteve të tij. Gjatë vitit 2022, në përputhje me strukturën organizative, kapacitetet njerëzore të Entit janë rritur duke plotësuar strukturën me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, si një pozicion ndihmës kyç në aspektet ekzekutive të funksionimit të institucionit. Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 29 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës, struktura organizative e së cilës, jepet në figurën 1 të mëposhtme.




Figura nr.1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU ka përballë reformës së sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Në sektorin UK shërbimi i "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik" kryhet nga 58 shoqëri nga të cilat vetëm 2 prej tyre kryejnë edhe shërbimin e "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik". Shërbimi i "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura" ofrohet nga 53 shoqëri ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet vetëm nëpërmjet 8 (tetë) impianteve të ndërtuara, ndër të cilat vetëm 5 (pesë) prej tyre janë të pajisur me licencë nga ERRU, pasi 3 (tre) prej tyre ende nuk plotësojnë kërkesat ligjore për licencim për këtë kategori shërbimi.

Qeveria qendrore mori nismën për agregimin e shoqërive UK që operojnë në sektor duke krijuar Shoqëri me Kompetenca të përbashkëta (**SKP**) bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të UN”*, i cili parashikon riorganizimin e sektorit nga 58 shoqëri UK ekzistuese në 15 shoqëri Rajonale UK që si formë organizimi e ekonomisë së shkalles ka si qëllim përmirësimin e performancës së shërbimit të shoqërive të vogla dhe sektorit UK në tërësi.

Gjatë vitit 2022, pranë ERRU-së në total kanë paraqitur dokumentacionin për licencim 20 shoqëri UK nga të cilat 17 të riorganizuara sipas VKM nr.63, datë 27.01.2016 (shoqëritë ekzistuese) dhe 3 (tre) Shoqëri UK Rajonale të krijuara sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022.

Në zbatim të VKM nr.302, deri në përfundim të procesit të krijimit të shoqërive të reja rajonale Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi vendimin nr. 420, datë, 29.09.2022 *“Për licencat dhe tarifrat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”*, ku në pikën 1 të saj citohet që: *Shoqërive UK të cilat janë të pajisura me licencë nga ERRU për operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe kanë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me MIE për krijimin e Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”*, **ERRU u jep të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta.***

Sa më sipër, Shoqëritë UK në momentin që përfundojnë procedurat e riorganizimit në formën e SKP, **duhet të aplikojnë pranë ERRU brenda tre muajve nga përfundimi i procesit të plotë të transferimit**, për pajisjen me licencë të re shërbimi në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për licencimin e tyre.

Në zbatim të VKM nr.302, menjëherë filluan procedurat për agregimin e shoqërive UK dhe deri në mbyllje të vitit 2022, këtë proces e kanë përfunduar dhe janë krijuar 12 shoqëri të reja rajonale UK. Nisur nga parashikimet e VKM-së mbeten akoma 3 shoqëri rajonale të pa krijuara, si **Shoqëria Rajonale UK Shkodër**, ku përfshihen shoqëritë UK Shkodër, UK Fushë Arrëz, UK Pukë, UK Vau i dejës, UK Malësi e Madhe, **Shoqëria Rajonale UK Vlorë**, ku përfshihen shoqëritë UK Vlorë, UK Selenicë dhe UK Himarë dhe **Shoqëria Rajonale UK Tiranë**, ku përfshihen shoqëritë UK Tiranë, UK Kamëz dhe UK Vorë. Megjithëse VKM nr. 302 parashikon agregimin e sektorit UK në 15 shoqëri rajonale, ajo nuk është detyruese për riorganizimin në SKP, pasi bazohet në parimin e marrëveshjeve me vullnet të lirë midis Pushtetit Vendor si pronarë i shoqërive UK dhe Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës.

Nga 12 shoqëritë rajonale të krijuara deri në mbyllje të vitit 2022 arritën të aplikojnë në ERRU për licencim vetëm 3 shoqëri, si Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a, Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a. dhe shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a, prej të cilave vetëm 2 prej tyre janë licencuar nga ERRU, Shoqëria Rajonale UK Korçë dhe Shoqëria Rajonale UK Lezhë, ndërsa shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a nuk arriti të pajiset me licencë nga ERRU brenda vitit 2022 për mungesë dokumentacioni dhe pritjet licencimi i saj në fillim të vitit 2023.

Në Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a përfshiheshin shoqëritë ekzistuese UK Korçë, UK Kolonjë, UK Devoll, UK Maliq dhe UK Pustec (e cila nuk ka qenë e licencuar më parë nga ERRU) dhe përsëri Bashkia Pustec mbeti jashtë zonës së shërbimit të licencës së re të Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a për shkak të mos pajisjes me Akt Miratim Higjiëno-Sanitar.

Në përfundim, gjatë vitit 2022, Enti Rregullator i Ujit ka marrë në shqyrtim kërkesën për licencim apo rinovim licence dhe ka miratuar licencat për 17 shoqëri UK. Janë licencuar 15 shoqëri UK të riorganizuar sipas VKM nr.63, datë 27.01.2016 (shoqëritë ekzistuese) pasi shoqëria UK Rrogzhinë dhe UK Libohovë mbeten në proces, fillimisht për mos plotësim të dokumentacionit sipas VKM nr. 958 dhe më pas nga lënia pezull e statusit të tyre duke qenë se në zbatim të VKM nr.302, shoqëritë filluan të merreshin me procesin e agregimit me shoqëritë e reja rajonale. Gjithashtu, janë licencuar edhe 2(dy) Shoqëri UK Rajonale, UK Korçë dhe UK Lezhë, pasi shoqëria rajonale UK Kukës mbeti në proces licencimi, për mungesë dokumentacioni. (shih aneksi 1, tabela 1).

Aplikimet për licencim kanë rezultuar nga arsyet e mëposhtme :

- a) Përfundimi i afatit të licencës për 6 (gjashtë) shoqëri;
- b) Ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik në 9 (nëntë) shoqëri UK;
- c) Licencim për herë të parë 1 (një) shoqëri UK Kamëz;
- d) Aplikim për ndryshim të zonës së shërbimit për 1 (një) shoqëri, UK Tiranë.
- e) Aplikim si Shoqëri UK Rajonale për 3 (tre) shoqëri UK Korçë, UK Lezhë dhe UK Kukës.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2022 për shoqëritë UK ekzistuese dhe të ndara sipas shoqërive të reja rajonale paraqitet në aneks 1, tabela 2. Nisur nga kjo tabelë shihet se deri në mbyllje të vitit 2022 në sektor janë 43 shoqëri UK ekzistuese (para reformës) me licenca të vlefshme dhe 2 shoqëri UK Rajonale të licencuara për herë të parë sipas reformës (të cilat përbejnë 8 shoqëri UK ekzistuese, por UK Pustec mbetet akoma pa licencë), mbeten 9 shoqëri UK pa licencë konkretisht UK Tropojë, Klos, Rrogzhinë, Patos, Divjakë, Pustec, Përmet, Dropull dhe Libohovë. Siç u përmend edhe më sipër në vijim të reformës procesi i licencimit për këto shoqëri është stopuar pasi tashmë janë pjesë e shoqërive UK Rajonale të cilat pritet të aplikojnë për licencim si shoqëri të reja në fillim të vitit 2023.

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

ERRU në fund të vitit 2021 ka miratuar dokumentin “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, me vendimin e KKRR nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, bazuar në ligjin nr. 8102 datë 28.06.1998 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.

Në vijim të miratimit të metodologjisë së re të tarifave, në fillim të vitit 2022, ERRU, ka organizuar katër seminare rajonale përkatësisht në Tiranë, Lezhë, Korçë dhe Vlorë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 58 shoqëritë UK që operojnë në sektorin UK në vend.

Qëllimi i këtyre seminareve ishte prezantimi dhe njohja me ndryshimet e përfshira në metodologjinë e re të miratimit të tarifave UK. Në vija të përgjithshme këto ndryshime konsistojnë, përkatësisht në përcaktimin, përkufizimin dhe shpërndarjen e kostove sipas shërbimeve, rregullimin e orientimit të

tarifës fikse, rregullimin e normave të amortizimit, përcaktimin e të ardhurave të nevojshme, planifikimin e vëllimeve në bilancin e ujit, rregullimin e mbajtjes së një sistemi informacioni nga shoqëritë, monitorimin e treguesve kryesorë të performancës, përditësimin e tarifave nëpërmjet vlerësimit të performancës dhe efijencës së kostove me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe më pas vetëfinancimin e investimeve të nevojshme për shoqëritë UK. Në këto seminare u prezantua në detaje gjithashtu edhe mënyra e plotësimit të modelit të aplikimit të ri dhe të raportimit vjetor të të dhënave. Në seminare morën pjesë përfaqësues të drejtuesve ligjorë dhe stafeve të tyre tekniko-ekonomike të të gjitha shoqërive UK, të cilët e vlerësuan si praktike, të plotë dhe mjaft elastike metodologjinë në drejtim të plotësimit të kërkesave të sektorit sipas gjendjes aktuale të performancës financiare të tij, si edhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare në të ardhmen.

Nëpërmjet metodologjisë, ERRU ka përcaktuar rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur për llogaritjen e tarifave të shitjes me shumicë e pakicë të ujit për konsum publik, të ujërave të përdorura dhe trajtimit të tyre si dhe afatet dhe kushtet e shërbimit për çdo veprimtari të ushtruar nga operatorët në sektorin e FU dhe KUN, në mënyrë që të arrihet një performancë e qëndrueshme teknike e financiare me në fokus mbrojtjen e klientëve nga çmimet monopol.

Metodologjia e re konsiston në dy metoda të përcaktimit të tarifave, metoda “Kosto Plus” për shoqëritë që mbulojnë deri në 100% kostot operacionale dhe metoda “Çmimi Tavan” për shoqëritë që mbulojnë mbi 100% kostot operacionale.

Në vitin 2022 ERRU ka trajtuar aplikimet për të cilat është marrë vendimi i fillimit të procedurës së aplikimit në fund të vitit 2021, por edhe aplikimet për të cilat ky vendim është marrë gjatë vitit 2022, prandaj procesi tarifor dhe miratimi i tarifave bazohet në vendimet si më poshtë:

- Për aplikimet për tarifa të vitit 2021, procesi tarifor dhe miratimi i tarifave bazohet në Vendimin nr.39 datë 09.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e FU dhe KUN”, në Vendimin nr.40 datë 09.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e FU dhe KUN”, në Vendimin nr.41 datë 09.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e FU dhe KUN” dhe në Vendimin nr.42 datë 09.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e FU dhe KUN”.
- Për aplikimet për tarifa të vitit 2022, procesi tarifor dhe miratimi i tarifave bazohet në Vendimin nr.539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve UK”.

Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar pranë ERRU propozimet për tarifa të reja për 5 shoqëri UK, përkatësisht UK Kukës, UK Konispol, UK Bulqizë, UK Durrës dhe UK Elbasan, për të cilat ka përfunduar analiza teknike ekonomike e janë marrë vendimet përfundimtare për tarifa siç paraqiten në tabelën nr.2.

Tabela nr.2 . Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet për ndryshimin e tarifave

Nr.	Shoqëria	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Bulqizë	381	31.08.2022
2	UK Kukës	382	31.08.2022
3	UK Konispol	383	31.08.2022
4	UK Durrës	508	27.10.2022
5	UK Elbasan	576	02.12.2022

Arsyet kryesore të aplikimeve për tarifa të reja nga shoqëritë e mësipërme kanë qenë:

- Përbushja e detyrimit ligjor nga shoqëritë UK për të aplikuar për tarifa të reja, sipas pikës 3, kreu II, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN", nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre, duke qenë se aplikohen tarifa të ndryshme për zona të ndryshme të shërbimit.
- Përbushja e detyrimit ligjor nga shoqëritë UK të aplikimit për tarifa të reja sipas vendimit nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe KUN", nga nevoja për të ofruar shërbimin e shitjes së ujit me shumicë zonave që nuk përfshihen në zonën e saj të shërbimit si shoqëri rajonale.
- Përbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar tarifa të miratuara nga ERRU, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN ", si autoritet i vetëm që miraton tarifën e shërbimeve UK.
- Aplikimi për tarifa të reja për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, në përputhje me nenin 22, Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN ", për mbulimin 100% të kostove operacionale me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar, mirëmbajtjen e rrjetit, stacioneve të pompimit, makinerive etj.
- Aplikim të tarifa të reja për shkak të rritjes së çmimeve/njësi sidomos të energjisë elektrike dhe materialeve për shoqëritë që prodhojnë ujë me ngritje mekanike si edhe të pagës minimale në shkallë vendi.

Detaje të aplikimeve të mësipërme jepen më poshtë:

UK Bulqizë ka aplikuar për herë të parë pas riorganizimit, pas një periudhe 10 vjeçare, në Shtator 2021, për tarifa të unifikuara, si edhe për herë të parë për tarifë të shërbimit të KUN. Me tarifën e reja të miratuara synohet gjithashtu mbulimi 100% i kostove operative dhe amortizimit vjetor si dhe rregullimi i të dhënave dhe variablave sipas kërkesave të ERRU-së.

UK Kukës ka aplikuar në Tetor 2021, pasi tarifave u ka mbaruar afati, për vendosjen e tarifës fikse dhe nivelit të ri tarifor për të gjithë zonën e shërbimit. Tarifën e reja të miratuara synojnë mbulimin 100% të kostove operative dhe 84% të kostove totale me fokus përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit, i cili pengon shoqërinë në krijimin e mundësive për likuiditet.

UK Konispol ka aplikuar në Dhjetor 2021, për të miratuar tarifën për herë të parë pas licencimit. Kjo shoqëri ofron vetëm shërbimin e FU dhe aplikon vetëm tarifën volumetrike të FU. Me tarifën e reja të

miratuara përmbushet kushti ligjor që shoqëria UK duhet të operojë me tarifa të miratuara nga ERRU, si autoritet i vetëm ligjor që miraton tarifatat e shërbimeve UK.

UK Durrës ka aplikuar në Qershor 2022, për të miratuar vetëm tarifatat e shitjes së ujit me shumicë për UK Kurbin dhe UK Vorë, pasi klientët e këtyre zonave nuk i takojnë më zonës së shërbimit si shoqëri rajonale, e cila është krijuar sipas vendimit nr.302, datë 11.05.2022. Me tarifatat e reja synohet rregullimi i shoqërisë UK Durrës duke vendosur kategorinë e klientëve të shitjes së ujit me shumicë për klientët që i takojnë UK Vorës dhe UK Kurbin me tarifa të miratuara nga ERRU.

UK Elbasan ka aplikuar në qershor 2022, për të miratuar tarifa të unifikuara për të gjithë zonën pasi është bashkuar me Elbasanin fshat, që më parë ka qenë shoqëri më vete. Nga ana tjetër, duke qenë se në këtë shoqëri 90% e volumit të ujit të prodhuar është me ngritje mekanike, aplikimi i ri ka si synim mbulimin e kostove të energjisë elektrike pas rritjes së çmimit/njësi nga ERE nga 11,5 lek/kWh në 18,8 lek/kWh.

Theksohet fakti se, kostot e secilit shërbim në aplikime paraqiten veç në modelin e aplikimit në mënyrë që të llogariten nevojat për të ardhura dhe tarifatat të jenë të orientuara drejt kostove të shërbimeve përkatëse. ERRU vlerëson performancën aktuale dhe të pritshme të këtyre shoqërive, duke përcaktuar dhe objektiva për të ardhmen të cilat janë objekt monitorimi në vijim të punës nga ERRU.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, konstatohen probleme lidhur me raportimin e të dhënave kryesisht për numrin e lidhjeve të reja që nuk përputhen me planifikimin e vëllimeve të parashikuara për faturim, në plotësimin e bilancit të ujit, konsumi i parashikuar i energjisë elektrike dhe kosto e parashikuar për paga e sigurime nuk kanë rezultuar të llogaritura saktë. Paraqitja e tarifave aktuale në modelin e aplikimit ka hasur vështirësi për shkak të përfshirjes së shumë zonave të cilat kanë mbartur tarifa të ndryshme. Këto problematika kanë ndikuar në zgjatjen në kohë të procesit tarifar, pasi ERRU ka verifikuar dhe saktësuar në detaje çdo element për të përfunduar një analizë të plotë të situatës teknike dhe ekonomike të shoqërisë. Në zbatim të metodologjisë së re të aplikimit, shoqëritë rajonale, duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë sistemet e informacionit për të dhënat pasi ERRU do të vlerësojë cilësinë e të dhënave të raportuara, të cilat do të ndikojnë në vendimin përfundimtar të tarifave të aprovuara prej saj.

ERRU, në kuadër të mbrojtjes së klientëve nga tarifatat e larta dhe të pajustificuara në analizën dhe vendimmarrjen për tarifa të reja vlerëson kriterin e përballueshmërisë së faturës së llogaritur për shërbimet e ofruara për konsumatorët familjarë. Fatura e llogaritur me tarifatat e miratuara nga ERRU nuk e kalon nivelin prej 5% të shpenzimeve mujore të Njesisë Ekonomike Familjare (NJEF), që INSTAT publikon në dokumentin "Anketa e Buxhetit të familjes për vitin 2021" e publikuar në vitin 2022 për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Tendenca e ndryshimit të tarifave për shërbimet FU dhe KUN ka ardhur në rritje për shkak të rritjes në përgjithësi të kostove njësi në vitin 2022, e sidomos të kostove të energjisë elektrike. Referuar faktit që në respektimin e kriterit të përballueshmërisë ka akoma rezerva jo të vogla, ERRU inkurajon propozime me rritje graduale të tarifave sepse një rritje e menjëhershme e tyre krijon probleme të uljes së normës së arkëtimit.

Rritja e kostove të energjisë elektrike pas krizës globale të energjisë dikton nevojën për marrjen e masave për menaxhimin e kostove të energjisë, të cilat duhet të bazohen në raporte studimi për efikasitetin e energjisë elektrike, për të cilat ERRU kërkon hartimin e menjëhershëm të tyre sidomos për shoqëritë që kanë konsum të lartë të energjisë elektrike për shkak të prodhimit të ujit me ngritje mekanike.

Mbështetja e shoqërive me subvencione nga qeveria qendrore vazhdon të jetë e domosdoshme, deri sa gradualisht nëpërmjet kostove efektive dhe planifikimit afatgjatë të arrihet të mbulohen me të ardhura të gjitha kostot operacionale në sektorin UK. Pritet që bashkimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale të reja të formuara në zbatim të reformës në sektorin e ujit të ketë ndikim pozitiv në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe të sektorit në përgjithësi.

Të gjitha projektvendimet për miratimin e tarifave përpara se të marrin formë përfundimtare nga ERRU, dërgohen për konsultim tek Shoqëritë UK dhe Bashkitë përkatëse, si edhe tek Autoriteti i Konkurrencës, të cilët mund të japin komentet e tyre përkatëse për to.

Pavarësisht se vlerësimin e aplikimeve të vitit 2022, ERRU i ka bërë në zbatim të metodologjisë së re të tarifave, metoda e re e vendosjes së tarifave me afat nëpërmjet periudhës rregullatore nuk arriti të realizohej për aplikimet e këtij vitit, pasi në zbatim të vendimit nr.302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe KUN”, shoqëria UK Elbasan, që ka aplikuar me modelin e ri të aplikimit, në fund të vitit 2022, ka bërë bashkimin me shoqëritë e tjera duke krijuar Shoqërinë Rajonale UK Elbasan. Prandaj të dhënat e planifikuara dhe objektivat e vendosura për vitin 2023, për UK Elbasan, do të bashkohen me të dhënat e shoqërive të tjera pjesë e shoqërisë rajonale të re të krijuar, duke e bërë të pamundur monitorimin e të dhënave të planifikuara dhe ato të realizuara, që do të kishin ndikim në përditësimin e tarifës.

ERRU, në zbatim të metodologjisë së re, për aplikimet për tarifa të shoqërive të reja rajonale, do të përcaktojë tarifa me afat nëpërmjet periudhës rregullatore bazuar detyrimisht në një Plan Biznesi 5-Vjeçar, të dhënat e të cilit do të monitorohen çdo vit për të vlerësuar realizimin, i cili do të ketë ndikim në tarifë dhe do të nxisë arritjen e objektiveve.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2022 ERRU ishte palë në 6 (gjashtë) procese gjyqësore nga të cilat 4 (katër) procese gjyqësore të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime.

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Mirditë sh.a

Palë paditëse:	Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur:	Ujësjellës Kanalizime Mirditë sh.a
Objekti:	Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Mirditë” sh.a. të shlyejë shumën 108 325 (njëqind e tetë e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 5853, datë 10.11.2022 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë.

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Kolonjë sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
 Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Kolonjë sh.a
 Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Kolonjë” sh.a. të shlyejë shumën 193 600 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Tropojë sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
 Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Tropojë sh.a
 Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tropojë” sh.a. të shlyejë shumën 463 750 (katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Krujë sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit
 Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Krujë sh.a
 Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Krujë” sh.a. të shlyejë shumën 997 167 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktua.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a

Palë paditëse: Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë sh.a
 Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit
 Person i tretë: Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor privat Florian Allkja
 Objekti: Kundërshtim veprimesh përmbarrimore në zbatim të vendimit nr. 4724, datë 01.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur “Mospranimin e padisë (ankimit)”. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

6. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit

Palë Paditëse: Luena Brekofca

Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit

Objekti:

1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 “Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës”;
2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara , përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditësh-i për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysmë shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë – padisë. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve

ERRU, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN”, i ndryshuar, ushtron aktivitetin e tij rregullator duke pasur në fokus mbrojtjen e konsumatorit nga shërbimi monopol dhe garantimin e cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura të ofruar nga shoqëritë UK. Gjithashtu, nëpërmjet shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, rregullatori evidenton problematikat që kanë shoqëritë UK në lidhje me ofrimin e shërbimit dhe jep rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2022, roli dhe kontributi i ERRU-së ka qenë i fokusuar në mënyrë të veçantë në hartimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2023 – 2030. Me urdhër të Kryeministrit Nr. 96, datë 10.06.2022 “Për ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2023 – 2030”, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit u angazhua në hartimin e dokumentit strategjik dhe planin e veprimit për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin e ujit 2023 – 2030, në drejtim të zbatimit të të drejtave të konsumatorëve dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe shoqërive UK. Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve në lidhje me shërbimin e FU dhe KUN si dhe bashkëpunimi ndërinstucional me aktorë si organizatat e konsumatorëve, shoqëria civile apo nivele të ndryshme të arsimit para universitar dhe universitar ishin gjithashtu një tjetër komponent i strategjisë për të cilën ERRU jo vetëm dha kontribut në pjesën e dokumentit, por parashikoi një sërë aktiviteteve sensibilizuese në drejtim të ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjen e rolit aktiv në sektorin e ujit.

Në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, në përputhje me Direktivën 2013/11/EU mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet konsumatore, ERRU krijoi brenda strukturës organizative Strukturën e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM), si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin FU dhe KUN. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022 është shtuar kontributi i ERRU-së si anëtare e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik" të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Angazhimi i ERRU-së, si pjesë e procesit drejt Integritimit Evropian dhe përafrimi i direktivave për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin e ujit, ka sjellë një qasje sa më afër konsumatorit, jo vetëm në mënyrën e zgjidhjes së ankesave, por edhe të krijimit të mekanizmave lehtësuese dhe sa më efikase në trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

- **Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve**

Gjatë vitit 2022, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit janë depozituar 10 ankesa të ardhura si nga konsumatorë familjarë, privat dhe institucione publike. ERRU ka vijuar trajtimin e ankesave duke ndjekur procedurat e komunikimit zyrtar me shoqëritë UK për të evidentuar mënyrën e trajtimit të ankesave nga shoqëria dhe respektimin e akteve nënligjore, të cilat rregullojnë marrëdhënien shoqëri UK - Konsumator. Në kuadër të edukimit të konsumatorëve dhe shoqërive UK për rolin ndërmjetësues që ka rregullatori për trajtimin e ankesave, orientimi dhe trajtimi i disa prej ankesave përgjatë vitit 2022 është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Theksohet fakti se konsumatorët i drejtojnë ankesat që kanë ndaj shoqërive UK, pranë ERRU-së, pasi kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për zgjidhjen e tyre me këto të fundit.

Natyra e ankesave edhe këtë vit ka qenë në tre kategori “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “faturimi aforfe”. Trajtimi i ankesave problematike siç është cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK, janë trajtuar me verifikime në terren ndërsa për dy ankesa të ardhura për faturim aforfe është parë e nevojshme zhvillimi i takimeve me shoqëritë UK. Referuar tabelës nr.3 të mëposhtme, nga totali i të gjithë ankesave, pesë prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Tabela nr. 3. Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2022

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1.	Faturimi Aforfe	3	1
2.	Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës	3	1
3.	Cilësia e shërbimit	4	3
TOTALI		10	5

Ofrimi i një shërbimi UK në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe ndërgjegjësimi i konsumatorit ka ndikuar vit pas viti në shtimin e numrit të ankesave me objekt “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”. Objektet e ankimit të këtyre lloj ankesave kanë qenë të fokusuar në probleme teknike për të cilat shoqëritë UK nuk kanë dhënë asnjë zgjidhje ose nuk i janë përgjigjur konsumatorëve. Këto lloj

ankesash pas angazhimit të shoqërisë dhe sugjerimeve të ERRU-së kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme dhe të favorshme për konsumatorët.

Kontrata për shërbimet UK përcakton të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies konsumator - shoqëri UK, ndaj respektimi i tyre është kusht kryesor për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. “Respektimi dhe zbatueshmëria e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime” ka qenë objekt ankimi për tre ankesa të tjera të ardhura pranë ERRU-së.

Ankesat e paraqitura në ERRU me objekt *“anulim i faturimit aforfe”* vijojnë të jenë pjesë e natyrës së ankesave që i drejtohen ERRU-së. Rastet e faturimit aforfe ku konsumatorët faturohen më shumë se norma e konsumit mujor për person e parashikuar në rastet kur konsumatori nuk ka ujëmatës, vijojnë të jenë objekt i ankesave pranë ERRU. Nga ankesat e këtij viti është evidentuar se konsumatorët familjarë, të cilët janë ankuar për faturimin aforfe kanë qenë konsumatorë të cilët janë me kolona të përbashkëta të furnizimit me ujë, ndaj edhe sugjerimi i ERRU-së ka qenë hartimi i planeve të veprimit konkrete nga ana e shoqërive UK për zgjidhjen e këtyre rasteve të ankimit dhe eliminimin përfundimtar të faturimit aforfe të konsumatorëve familjarë.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare (shkresë zyrtare), ERRU ka vijuar komunikimin dhe ka ofruar asistencë me të gjithë konsumatorët që janë drejtuar ERRU-së nëpërmjet konsultimeve verbale apo telefon për zgjidhjen e problemeve të tyre lidhur me shërbimet UK. Gjithashtu, përgjatë këtij viti është lançuar edhe mekanizmi më i ri i pranimit të ankesave të konsumatorëve, sistemi online nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al. Ky sistem online, ndërgjegjësimi i konsumatorit për të drejtat e tij dhe mekanizmat efektive që i ofrohen për të drejtuar ankesat e tij do të jenë pjesë e një fushate sensibilizuese që do të ndërmerret ERRU për vitin e ardhshëm.

1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

ERRU është institucioni i vetëm publik, i cili harton dhe publikon çdo vit Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit UK duke pasqyruar në të rezultatet e monitorimit të sektorit UK dhe të shoqërive UK gjatë një viti krahasuar me vitin paraardhës, me qëllim ecurinë e sektorit dhe transparencën për të gjithë aktorët e interesuar.

Në vijim të nevojës për të rritur cilësinë e monitorimit të sektorit dhe të forcimit të rolit të tij monitorues, tashmë që në vitin 2019, Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit UK realizohet me të dhënat e grumbulluara sipas formatit të data bazës të miratuar nga ERRU. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2022 i është kushtuar një rëndësi e veçantë monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi me qëllim nxitjen e një sektori financiarisht të qëndrueshëm, i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët.

Kjo praktikë i ka mundësuar ERRU-së krijimin e një panorame mjaft të qartë të larmisë së problematikave për të gjithë sektorin, të unifikuara ose jo, si edhe për dhënien e rekomandimeve në nivel strategjik për përmirësimin e performancës së sektorit në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme, shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

Raporti i publikuar u shpërndahet të gjitha shoqërive UK dhe aktorëve kryesorë të sektorit UK, si dhe është i disponueshëm në faqen e web-it të ERRU-së. Një formë e shkurtuar e tij është e disponueshme në gjuhën angleze po në këtë faqe web-i për të gjithë aktorët ndërkombëtarë që lidhen me sektorin, përfshirë dhe konsulentët e huaj.

Viti 2022, edhe pse në pjesën e dytë të tij është karakterizuar nga ndryshime thelbësore që kanë ndodhur në sektor si rezultat i reformës të miratuar nga qeveria qendrore në maj të këtij viti, nuk e ka penguar ERRU-në që të jetë aktive në monitorimin e sektorit UK. Krahas monitorimit të të dhënave të grumbulluara nga shoqëritë UK dhe analizës së tyre janë realizuar edhe monitorime në terren me shoqëritë UK, si një praktikë e zakonshme e ERRU-së me qëllim mbikëqyrjen e performancës dhe të problematikave që hasin shoqëritë e licencuara. Një gjë e tillë reflektohet edhe nëpërmjet numrit të lartë të vizitave që janë zhvilluar gjatë vitit 2022.

Konkretisht janë realizuar vizita monitorimi në 26 shoqëri UK të cilat janë vlerësuar se kanë raportuar kryesisht të dhëna të dyshimta që kanë patur nevojë për verifikime të mëtejshme, përkatësisht shoqëritë **UK Kavajë, Vorë, Peqin, Divjakë, Cërrik, Belsh, Fushë Arrëz, Përmet, Memaliaj, Këlcyrë, Kukës, Lushnje, Tropojë, Ersekë, Vau Dejës, Poliçan, Ura Vajgurore, Konispol, Delvinë, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Bulqizë, Dibër, Libohovë, Finiq, Kamëz dhe Krujë.**

Gjatë monitorimeve të shoqërive UK, përveç stafit drejtues kyç menaxhues, në përgjithësi kanë qenë të pranishëm edhe kryetarët e bashkive përkatëse, në rolin e pronarëve të shoqërive, me qëllim informimin në detaje mbi situatën dhe performancën e shoqërisë për të cilën janë përgjegjës.

Monitorimet e zhvilluara u fokusuan në këto drejtime:

- Zbatimi i ligjit të ERRU-së nr.8102 (vlefshmëria e licencës, tarifat e aplikuara dhe pagesa rregullatore);
- Krahasimi i performancës së shoqërive gjatë dy viteve të fundit (përmirësimet apo përkeqësimet e saj);
- Identifikimi i problematikave të hasura, (pengesat në përmirësimin e performancës së tyre);
- Situata financiare (nevoja për përmirësimin e performancës financiare);
- Saktësia e të dhënave (nevoja për raportime të sakta)

Gjatë takimeve është konstatuar përsëri se saktësia e të dhënave vijon të mbetet një nga problematikat kryesore që ka sektori UK. ERRU thekson në mënyrë të vazhdueshme edhe në prani të kryetarëve të bashkive vëmendjen që i duhet kushtuar nga ana e stafeve drejtuese të shoqërive, raportimit të të dhënave pranë ERRU-së që në mjaft raste janë të ndryshme nga ato që ato raportojnë tek AKUM-i.

Pasaktësia e të dhënave të raportuara influencon në drejtim të konkluzioneve të gabuara gjatë analizës së performancës që i bëhet shoqërive UK çdo vit, e cila publikohet edhe në raportin e performancës së sektorit UK. Saktësia e këtij raporti ka një rëndësi të veçantë, pasi shpesh herë të dhënave i referohen edhe institucionet e tjera shtetërore, të huaja, donatorët, mediat si dhe publiku i gjerë.

ERRU, në vijim dhe të ndryshimeve që po ndodhin në sektorin UK si rezultat i reformës në drejtim të agregimit të tij, do të vijojë të jetë proaktive me të njëjtin intensitet në monitorimin e shoqërive UK

edhe gjatë vitit 2023, duke e rritur nivelin e kërkesës ndaj tyre, në mënyrë që të arrijmë të kemi shoqëri të shëndosha financiarisht dhe të afta për të ofruar shërbime sa më cilësore ndaj konsumatorëve. **Monitorimi nga ERRU, në këtë rast ku qeveria qendrore ka 51% të aksioneve të shoqërive rajonale UK (SKP), merr një rëndësi të veçantë për objektivitetin dhe transparencën e vlerësimit të performancës së sektorit UK.**

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Viti 2022 ka qenë mjaft intensiv në sferën e marrëdhënieve të ERRU-së me rrjetin e bashkëpunëtorëve bazuar në marrëveshjet e nënshkuara me to. Me lehtësimin e kufizimeve në lëvizje post pandemisë, stafi i ERRU ka patur mundësi të ndjekë nga afër aktivitete si brenda dhe jashtë vendit, duke forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale si dhe duke rritur njohuritë e stafit mbi zhvillimet e fundit në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2022 ka konsistuar në informimin periodik të veprimtarisë institucionale të rregullatorit, si dhe të gjendjes së sektorit të ujit. Së pari, përmes raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit mbi veprimtarinë vjetore të punës si edhe përmes takimeve të organizuara nga Kryetari i Kuvendit. Në vijim të zbatimit të mekanizmit ndërinstitucional për forcimin e sistemit të monitorimit të të dhënave dhe rekomandimeve të institucioneve të pavarura, bashkëpunimi me Kuvendin ka vazhduar me raportimet periodike mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në rezolutë.

1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

ERRU ka vijuar bashkëpunimin me MIE përgjatë vitit 2022 në kuadër të reformës së ndërmarrë për riorganizimin e sektorit të UK në Shqipëri. Pas miratimit të këtij vendimi nga MIE, ka lindur nevoja për rishikimin dhe përgatitjen e draft strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si dhe drafteve të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit në sektorin UK. ERRU, si një prej aktorëve kryesorë të sektorit, ka dhënë kontributin e tij në hartimin e strategjisë duke qenë pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe pjesëmarrjeve në mbledhje e takime në funksion të këtij dokumenti.

1.5.1.2.1 Me AKUM (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve)

Në vijim të forcimit të bashkëpunimit me AKUM i cili është intensifikuar gjatë vitit 2022 si rezultat edhe i reformës në sektorin UK. Në këtë kuadër janë realizuar mjaft takime ku janë diskutuar probleme të ndryshme të reformës që lidhen sidomos me respektimin e ligjit për të realizuar në kohë procesin e licencimit të shoqërive rajonale, si edhe të tarifave të shërbimeve UK. ERRU ka bashkëpunuar gjatë këtij viti me AKUM gjithashtu në lidhje me projektin “Planifikimi i sektorit të ujit, për negociatat me BE-në”, në kuadër të Marrëveshjes së Grantit të firmosur ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj suedeze. Qëllimi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i kapaciteteve strategjike dhe planifikuese në Sektorin e Ujit për zbatimin e direktivave/standardeve me BE-në. Konkretisht, për zbatimin e këtij

projekti në nëntor të vitit 2021, përveç konsulentit, nga AKUM, u ngritën grupet e punës ndërinstitucionale me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse dhe kontribues në sektorin e ujit, ku nga ERRU u caktuan tre përfaqësues për zhvillimin e projektit, duke qenë pjesëmarrës në grupet përkatëse:

Grupi Punës 1, i cili do të merrej me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Ndotura;

Grupi Punës 2, do të merrej me Direktivën e Ujit të Pijshëm;

Grupi Punës 3, do të merrej me hartimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Llumrave.

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar takimet përkatëse të grupeve të punës të organizuara nga Konsulentët dhe janë përgatitur draftet finale përkatëse të Raporteve të Planeve Specifike për Zbatimin e Direktivës së Ujit të Pijshëm (DWD) dhe Ujërave të Ndotura (UWWTD) dhe Raporti i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Llumrave (NSMS) nga ekspertët ndërkombëtarë ku përfaqësuesit e emëruar nga ERRU, kanë qenë pjesë aktive e këtyre takimeve.

1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERRU edhe përgjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjen e interesave publike në sektorin e ujit. ERRU ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për pesë projektvendime për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Konkretisht për shoqëritë: UK Bulqizë, UK Kukës, UK Konispol, UK Durrës dhe UK Elbasan.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Një ndër prioritetet e ERRU-së mbetet përfaqësimi aktiv dhe dinjitoz i punës së rregullatorit në aktivitetet rajonale ballkanike dhe ndërkombëtare me qëllim për t'u njohur me qasje të reja rregullatore dhe përthithjen e përvojave e modeleve më të mira.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

Si anëtare e **Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG)**, ERRU ka qenë rregullisht në mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme, si dhe seminareve të organizuara prej saj. Në muajin prill daton dhe mbledhja e parë e Asamblesë për vitin 2022, e zhvilluar në një format hibrid, midis prezencës fizike në Azora të Portugalisë dhe asaj online, në të cilën u diskutuan treguesit kryesorë të performancës, bazuar në pyetësin përkatës nga 33 vendet anëtare të WAREG.

Mbledhja e dytë u zhvillua përgjatë 22-23 shtator me fokus krizën energjitike dhe masat që po ndërmarrin rregullatorët në zbutjen e ndikimit të saj në sektorin e ujit. Në këtë mbledhje u bë edhe një prezantim me mjaft interes për vendin tonë, mbi përfshirjen e anëtarëve të WAREG në zbatimin e Direktivës së re të Ujit të Pijshëm.

Edhe mbledhja e fundit e Asamblesë, mbajtur në Hungari në fund të muajit nëntor, kishte në qendër të diskutimeve ndikimin e krizës së energjisë në tarifa dhe se si po adresohet nga vende të ndryshme, si edhe përditësimin e Direktivave Evropiane për ujin e pijshëm dhe ujërat e ndotura.

Duke qenë pjesë e WAREG, Enti Rregullator i Ujit është përfaqësuar në seminare e workshop-e të shumta online, ku anëtarët kanë diskutuar për rolin, eksperiencën dhe sfidat në sektor, midis tyre edhe Shqipëria. Në tetor, ERRU prezantoi disa nga problematikat, si dhe angazhimin e qeverisë qendrore e institucioneve të tjera në realizimin e reformës së ujit dhe përmirësimin e treguesve të performancës.

Shkëmbimi i njohurive dhe ekspertizës është instrumenti kryesor që bashkon rregullatorë të shumtë, pjesë e WAREG. Organizime të tilla, qoftë online apo me prezencë fizike, me prezantime nga shtete që kanë përshkruar më parë rrugëtimin që po kalon vendi ynë tani, siç është agregimi i sektorit UK, shërbejnë për të adaptuar modelet më të mira.

Në qershor, ERRU u bë pjesë e seminarit të organizuar nga **Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE)** mbi aksesin e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. I ftuar për të referuar në sesionin e tretë të seminarit, fokusuar në praktikën e mira mbi përballueshmërinë e tarifave të shërbimit, kryetari i ERRU ndau eksperiencën e vendit tonë në lidhje me praktikën që ERRU përdor si kritere për përballimin e faturave të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve për konsumatorët. Në dy ditë seminar, i cili u mbajt në Gjenevë të Zvicrës, u diskutua mbi zhvillimet e reja në zonën evropiane mbi aksesin e barabartë në shërbime, përfshirë progresin dhe sfidat në implementimin e Direktivës Evropiane për Ujin e Pijshëm për vendet që nuk janë pjesë e BE-së. Përfaqësues nga autoritete të vendeve të ndryshme prezantuan modelet e tyre dhe mësimet që nxorën nga situata me covid-19, sa i takon sigurimit të plotë të aksesit të qytetarëve në shërbimet e ujit.

Një tjetër aktivitet me rëndësi gjatë vitit 2022 ishte Kongresi Botëror i Ujit, organizuar nga **Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA)** në kryeqytetin e Danimarkës, Copenhagen, i cili u shoqërua në të gjitha ditët nga një ekspozitë e dedikuar e inovacioneve në fushën e ujit. Në një takim të nivelit të lartë u mbledhën përfaqësues të rregullatorëve ekonomikë të ujit nga e gjithë bota, midis të cilëve edhe Shqipëria, e cila prezantoi veçoritë e angazhimit dhe të sfidës për mbulimin me shërbimet e KUN në vendin tonë, si dhe rolin mjaft të rëndësishëm të rregullatorit për përballimin e këtyre sfidave dhe të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Të gjitha diskutimet u përqendruan në rregullimin e sektorit UK në një kohë pasigurie natyrore, sociale dhe ekonomike në rritje.

Një marrëdhënie për t'u veçuar përgjatë këtij viti është ajo me **Komisionin Evropian**. Ky i fundit zhvilloi në 14 tetor 2022 takimin e radhës shpjegues për kapitullin 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit", në të cilin mori pjesë një përfaqësues nga Enti Rregullator i Ujit. Aty u dhanë informacione dhe sqarime mbi përditësimin e akteve në fuqi të kapitullit 28 me qëllim përafrimin me legjislacionin evropian. Për çështje që kanë të bëjnë specifikisht me sektorin e ujit, ERRU do të kontribuojë në hartimin e prezantimeve dypalëshe, të cilat janë parashikuar të zhvillohen në fillim të vitit 2023.

1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë

Një rëndësi të veçantë përgjatë vitit 2022, ERRU i ka kushtuar bashkëpunimit me donatorë e aktorë të shumtë vendas e të huaj, të cilët përmes programeve të tyre kanë lehtësuar komunikimin midis aktorëve kryesorë të sektorit të ujit midis vendeve të ndryshme në mbarë botën.

ERRU është intervistuar nga **Banka Botërore** për projektin për zhvillimin e "ekonomisë blu" në Shqipëri. Në një takim në ambientet e institucionit, përfaqësues nga të dy institucionet kanë diskutuar

në lidhje me implikimet e infrastrukturës së shtuar sanitare që parashikon ky projekt në rregullimin ekonomik të shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve në mbrojtje të lumit Vjosa nga impaktet e ujërave të ndotura që derdhen në këtë lumë nga 7 bashki: Tepelenë, Gjirokastër, Përmet, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj dhe Leskovik.

Gjithashtu, në maj, ERRU ishte pjesë e një tryeze të rrumbullakët online, organizuar po nga **Banka Botërore**, fokusuar në mënyrën se si rregullatorët mund të stimulojnë qëndrueshmërinë, inovacionin dhe gjithë përfshirjen në shërbimet e FU dhe KUN. Më rëndësi për ERRU mbetet adaptimi i zgjidhjeve të përgjegjshme, elastike dhe në mbrojtje të mjedisit gjatë ofrimit të shërbimit.

Në qershor u organizua forumin vjetor i **Danubit për Ujin** në Tiranë që u zhvillua me prezencë fizike, nën organizimin e SHUKALB, ku ERRU ishte i pranishëm me përfaqësuesit më të lartë nga sektori i ujit në 19 shtete të botës, të cilët parashtruan zhvillimet më të fundit në sektorin e ujit dhe efektet e krizës së energjisë në shoqëritë e rajonit të Danubit. Mbi këtë tematikë u mbajt një prezantim nga ERRU, në të cilin u theksua se rregullatorët janë aleatët kryesorë të qeverive në adresimin e situatave emergjente e po ashtu institucione të besueshme për të mbrojtur konsumatorin.

Në qershor gjithashtu u mbajt konferenca e organizuar nga **GIZ Albania, IAWD dhe**, shoqatat SHUKALB e SHUKOS (Kosovë) me temë “Lidhja e Benchmarking dhe Menaxhimit të Aseteve – Mjetet kryesore për rregullatorët dhe vendimmarrësit”, e cila solli një panoramë temash mbi ngjashmëritë dhe krahasimin e asetëve të ujësjellësve në Rajonin e Danubit.

Në vijim të bashkëpunimit të ngushtë që ERRU ka me Shoqatat SHUKALB dhe SHUKOS, ERRU mori pjesë aktive në Konferencën dhe Ekspozitën Ballkanike të përvitshme me temë: “Ujërat Nëntokësorë – Të Bëjmë të Padukshmen të Dukshme” që u mbajt në Kosovë. Përfaqësuesi i ERRU-së moderoi seksionin e tretë teknik të fokusuar në sfidat rregullatore, duke veçuar ndryshimet klimatike, luftën në Ukrainë dhe kostot e rritura të energjisë si vështirësitë më të mëdha që kanë impaktuar sektorin e ujit. Po ashtu pati një prezantim mbi “Rajonalizimin e Shërbimeve UK”, duke u ndalur veçanërisht në rolin e rregullatorit dhe detyrimet ligjore në fazën e riorganizimit të shoqërive UK, nga 58 në 15 të tilla. ERRU mori pjesë gjithashtu edhe me një tjetër prezantim “Mbi specifikat e metodologjisë së re të tarifave të shërbimeve UK” që është aprovuar së fundmi nga ERRU për sektorin UK.

1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së

Enti rregullator i Ujit ka nënshkruar më herët marrëveshje bashkëpunimi dy palëshe me rregullatorët rajonalë të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, por në vitin 2022 marrëdhënia midis tyre kaloi në një tjetër nivel. Në 18 Maj, katër autoritete rregullatore të sektorit të ujërave në Ballkanin Perëndimor: Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut, në praninë edhe të përfaqësuesve të drejtuesve të lartë të WAREG, firmosën një Memorandum Bashkëpunimi, përmes të cilit adresohen sfidat e përbashkëta në fushën e UK, avancimin në përafrimin e legjislacionit të BE-së për ujërat si dhe vendosjen e themeleve për një program bashkëpunimi rajonal. Në ceremoninë e organizuar nga ERRU në Tiranë morën pjesë presidenti i WAREG, zv. Ministrija e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues nga AKUM, SHUKALB në Shqipëri e të tjerë, të cilët e cilësuan këtë marrëveshje një moment historik dhe të një rëndësie të veçantë për forcimin e bashkëpunimit me përfitime ekonomike dhe mjedisore.

Në Torino të Italisë u mbajt gjithashtu Asambleja e 25-të e WAREG, kryetarët e katër rregullatorëve në Ballkanin Perëndimor zhvilluan në shtator 2022 takimin e parë ku diskutuan pikat e mëtejshme të bashkëpunimit si dhe rolin e WAREG në promovimin e integritetit rajonal dhe mbështetës në përafrimin

drejt EU 'Acquis Communautaire' të vendeve kandidate dhe ato me potencial për t'iu bashkuar unionit evropian.

Në fundin e vitit 2022, bashkëpunimi i ERRU-së me institucionet rregullatore evropiane të ERRU u konkretizua me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi me Rregullatorin Hungarez për Shërbimet e Ujit, Kanalizimeve dhe Energjinë (MEKH). Marrëveshja synon krijimin e një infrastrukture praktike bashkëpunimi midis dy autoriteteve duke transferuar njohuritë e përvojat më të mira që synojnë përmirësimin e sektorit të UK në të dy vendet. Më konkretisht, ERRU dhe MEKH ranë dakord të shkëmbejnë informacione, organizojnë workshop-e e vizita studimore me përfaqësues nga stafet përkatëse, si edhe publikime me interes të përbashkët, me theks të veçantë mbi eksperiencat dypalëshe të proceseve të tarifave të shërbimeve të UK, licencimit të shoqërive, agregimit të sektorit e të tjera.

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Veprimtaria e ERRU-së është e lidhur ngushtë me transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut, në funksion të përmbushjes së misionit të saj që është sigurimi i të gjithë konsumatorëve se ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve japin cilësinë më të mirë të mundshme, me çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Programi i Transparencës, i cili gjendet në faqen zyrtare të ERRU-së, (*erru.al*) përmban të gjithë informacionin që institucioni prodhon dhe disponon, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Gjatë vitit 2022, pranë institucionit janë paraqitur dy kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore.

Risia e këtij viti në drejtim të rritjes së transparencës është implementimi i faqes së re zyrtare të ERRU, e cila vjen në një format më dinamik dhe më të lehtë në përdorim, e plotësuar me rubrika shitesë si dhe ofron akses më të madh për konsumatorët. Përmes një dritare të posaçme, konsumatori mund të bëjë pyetje, të shtrojë një paqartësi apo kërkesë duke marrë përgjigje në kohë reale brenda orarit zyrtar. Ndërkohë, në panelin dedikuar konsumatorëve, jepet mundësia për të adresuar një ankesë edhe online, përpos dy formave tradicionale që janë: ankesa me shkrim përmes postës apo paraqitja e personit pranë ambienteve të ERRU-së.

Përgjatë vitit 2022, institucioni ka rritur prezencën në median online dhe atë elektronike përmes pasqyrimin të aktiviteteve, konferencave apo takimeve të ndryshme. Memorandumi i Bashkëpunimit midis katër Rregullatorëve Ekonomik për Ujin në Ballkanin Perëndimor tërhoqi vëmendjen e tyre duke e lidhur këtë marrëveshje me përfitimet që pritet të ketë vendi ynë në agregimin e sektorit UK falë përvojave të vendeve që janë një hap përpara. Gjithashtu, Kryetari i ERRU i është përgjigjur ftesave televizive për të informuar konsumatorët mbi aspekte që i shqetësojnë ata, si dhe ka adresuar përmes sqarimeve e njoftimeve për shtyp problematika apo lajme të pavërteta.

Rrjetet sociale gjerësisht të përdorura si: "LinkedIn", "Facebook", "Instagram" e "Twitter" përbëjnë shtylla të rëndësishme për informimin e publikut dhe pasqyrimin e veprimtarisë së ERRU. Ato janë përditësuar vazhdimisht në drejtim të pasqyrimin të aktiviteteve me rëndësi si dhe të rehat më të fundit nga sektori UK.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe pagesat për liçensimin e tyre përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN". ERRU ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar tarifa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2022, mbështetur në kontratat me 45 shoqëri UK, është në shumën 53, 676, 988 lekë. Detyrimi për pagesë rregullatore i mbartur nga vitet paraardhëse është 47, 902, 186 lekë.

Arkëtimet totale të ERRU të realizuara gjatë vitit 2022 janë në shumën totale 61, 178, 716 lekë. Për pagesa rregullatore janë 60, 398, 716 lekë dhe për tarifa licencimi janë 780, 000 lekë detajuar më poshtë në tabelën 4.

Tabela nr.4. Realizimi i Arkëtimeve Sipas Zërave

Nr.	Arkëtime gjatë vitit 2022	Vlera/ lekë
1	Nga pagesat rregullatore të prapambetura	20, 760, 552
2	Nga pagesat rregullatore të vitit 2022	39, 638, 164
3	Nga pagesat e licencimit	780, 000
Totali		61, 178, 716

Për mbledhjen e detyrimeve të papaguara në më shumë se dy vjet, shoqërive UK gjatë vitit 2022 u është kërkuar përmbushja e detyrimit, si dhe janë nënshkruar aktmarrëveshje për lehtësimin e shlyerjes me këste të vazhdueshme. Disa shoqëri, të cilat nuk kanë paguar vullnetarisht detyrimin sipas vendimit gjyqësor janë në proces për mbledhjen me forcë të tij nga zyra e përmbartimit.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt si detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar.

Likuiditetet në vitin 2022 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit për vitin 2023 të ERRU-së, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.7.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative propozohet nga ERRU dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN", i ndryshuar.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2022, është miratuar VKM nr. 782, datë 15.12.2021, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2022, për ERRU-në" Fondi i miratuar për shpenzimet operative është 53, 154, 530 lekë.

KKRR me vendimin nr. 27, datë 17.01.2022, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave, në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Plani vjetor është detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që paraqiten në grafikun nr. 1, si më poshtë:




Grafiku nr.1. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2022

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2022, janë në shumën 47, 924, 224 lekë, ose 90 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Realizmi i shpenzimeve në zëra dhe në vlera paraqiten si më poshtë:

- 30, 271, 101 lekë / 96%, shpenzime për pagat e punonjësve;
- 5, 179, 351 lekë / 94% shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 10, 189, 992 lekë / 75% shpenzime për shërbime e furniturë;
- 2, 283, 780 lekë / 97% shpenzime për investime.

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU, krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në vijim në formë grafike si më poshtë në grafikun nr. 2.



Grafiku nr.2. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM krahasuar me Shpenzimet e Realizuara

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2022

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e cila është miratuar me datë 14.04.2022, referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2021 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2022, realizimi i të cilave cituar sipas numrit rendor përkatës, rezultojnë si më poshtë:

1. ERRU-ja në bashkëpunim edhe me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUM), si dhe me aktorët e tjerë në Sektorin UK duhet të bashkërendojë punën për të qjetur zgjidhje konkrete dhe mekanizmat e duhur për të vënë në pozita pune ndërmarrjet UK dhe përmirësimin e performancës në sektor, veçanërisht të Ujit Pa të Ardhura .

Grandet apo financimet që jepen për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime duhet të kushtëzohen me arritjen e objektivave të vëna nga ERRU-ja dhe rritjen e performancës.

Është e pa pranueshme që edhe pse nga njëra anë investimet e qeverisë në sektorin e ujësjellës kanalizimeve rriten dhe nga ana tjetër humbjet (Uji Pa të Ardhura) për vite me radhë vijon të mbetet në nivele të larta ka keq menaxhim të ujësjellës kanalizimeve.

Sektori i FU dhe KUN prej një periudhe mjaft të gjatë operon me një tregues mjaft të lartë të humbjeve prej rreth 67% të natyrës administrative dhe fizike. Në fund rezultojnë që kjo përqindje kaq e madhe e ujit të prodhuar nuk i faturon konsumatorëve, që konsiderohet si Uji Pa të Ardhura, e cila ka një impakt mjaft negativ në performancën financiare të shoqërisë UK dhe të të gjithë sektorit në tërësi. Pjesa e humbjeve administrative (lidhjet e paligjshme, nënfaturimet e konsumatorëve, abuzuesit që nuk kanë ujëmatësa etj.) lidhen direkt me mundësitë për një menaxhim më të mirë të shoqërive UK nga stafet drejtuese dhe teknike të tyre, ndërkohë që humbjet fizike lidhen kryesisht me plotësimin e nevojave për investime në sistemet e furnizimit me ujë.

Mekanizmat që ERRU ka në dispozicion për të influencuar për performancën e sektorit kryesisht lidhen me treguesit e performancës për reduktimin e humbjeve administrative, ndërsa nuk ka influencë direkte apo indirekte për reduktimin e humbjeve fizike që lidhen me investimet fizike që administrohen nga MIE nëpërmjet AKUM-it.

Instrumenti bazë në të cilin mbështetet ERRU në analizën e humbjeve të ujit të shoqërive UK, është Raporti i Bilancit Vjetor të Ujit që shoqëritë duhet të dorëzojnë pranë ERRU-së, i cili shërben më tej për hartimin e Raportit të Bilancit të Ujit për të gjithë sektorin. Raporti i Bilancit të Ujit është gjithashtu pjesë e dokumentave që shoqëritë UK duhet të dorëzojnë kur aplikojnë për tarifa të reja pranë ERRU-së.

Duke analizuar bilancin e ujit, ERRU, vendos objektiva konkrete për shoqërinë për uljen e Ujit Pa të Ardhura që duhet të realizojë gjatë periudhës rregullatore të tarifave të miratuara. Këto objektiva vendosen të bazuara kryesisht nga reduktimi i humbjeve administrative.

Konkretisht edhe gjatë vitit 2022 në vendimet e tarifave të miratuara për shoqëritë UK Konispol, Kukës, Bulqizë dhe Elbasan janë vendosur objektiva optimiste për tu arritur prej tyre në drejtim të reduktimit të Ujit Pa të Ardhura, sipas tabelës nr.5 të mëposhtme .

Tabela nr.5. Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Shoqëria	Treguesi i vitit 2021 (%)	Objektivi i Vendosur nga ERRU Viti 2023 (%)
1	UK Konispol	35	30.3
2	UK Kukës	54.5	48.9
3	UK Bulqizë	46.3	40
4	UK Elbasan	73.87	70.61

Me metodologjinë e re të tarifave ku parashikohet që pjesë e dokumentacionit të aplikimit për tarifa të reja, shoqëritë duhet të paraqesin një Plan Biznesi 5 Vjeçar të aprovuar nga ERRU, pjesë e këtij plani janë edhe investimet e parashikuara gjatë periudhës rregullatore 5 vjeçare. Duket mjaft e arsyeshme që ERRU, në të ardhmen të jetë pjesë e procesit të shqyrtimit të nevojave për investime, si edhe të ketë një përfaqësues në Këshillat Teknike që AKUM-i analizon dhe aprovon projektet e paraqitura nga shoqëri të ndryshme të UK.

Nga ana tjetër, si institucioni që monitoron sektorin dhe shoqëritë UK, duket gjithashtu e arsyeshme që grantet apo investimet që i jepen shoqërive të bazohen edhe në arritjen e treguesve të performancës të vendosura si objektiva për shoqëritë nga ERRU në procesin e miratimit të tarifave. Ky mekanizëm për ofrimin e investimeve që përfshin edhe kontributin e ERRU, mund të shërbejë si element nxitës për shoqëritë për përmirësimin e treguesve të performancës.

Në vijim të reformës në sektorin UK, duhet një koordinim më i mirë i punës midis institucioneve kryesore, në mënyrë që të ketë një shpërndarje më të drejtë të investimeve për shoqëritë UK, për të përmbushur objektivat e caktuara nga ERRU me qëllim përmirësimin e performancës së tyre dhe ofrimin e një shërbimi me cilësori ndaj konsumatorit.

2. ERRU-ja të japë kontributin e saj konkret në kuadër të nismës së qeverisë qendrore, të ndërmarrë gjatë vitit 2021 mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare.

ERRU ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme nevojën e agregimit të sektorit UK si një sektor mjaft i fragmentarizuar me 58 shoqëri UK dhe ka mbështetur iniciativën e ndërmarrë nga qeveria qendrore mbi reformën në sektor si avantazh i ekonomisë së shkallës me qëllim përmirësimin e performancës së sektorit. Nisur nga ky fakt, ERRU ka dhënë kontributin e tij me ide dhe mendime konkrete mbi mënyrën e realizimit praktik të saj.

Qeveria qendrore me vendimin Nr. 302, datë 11.05.2022 “ Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe KUN” vendosi për agregimin e sektorit UK në 15 shoqëri UK Rajonale nga 58 të tilla që operojnë në sektor. Në vijim të këtij vendimi ERRU është treguar proaktive duke ndërmarrë disa veprime konkrete rregullatore në drejtim të licencimit dhe tarifimit të shoqërive UK rajonale në mënyrë që të lehtësojë ecurinë normale të këtij procesi gjatë periudhës tranzitore. Konkretisht, ERRU, ka marrë vendimin Nr. 420, datë, 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifatat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”. Me anë të këtij vendimi ERRU, i jep të drejtën shoqërive UK ekzistuese për transferimin e licencave drejt shoqërive UK Rajonale të krijuara si dhe i lejon shoqëritë UK Rajonale të aplikojnë të njëjtin nivel tarifor sipas zonave të shërbimit ekzistuese deri në momentin e licencimit të tyre si shoqëri të reja UK Rajonale dhe aplikimit për nivel të ri tarifor. Ky vendim ka shërbyer për të eliminuar burokracinë e tepërt dhe me humbje kohe që secila nga shoqëritë UK përbërëse të shoqërisë UK rajonale të aplikonte më vete pranë ERRU-së për të marrë aprovimin për të drejtën e transferimit të licencës tek shoqëria UK rajonale, si dhe ka aprovuar/ligjëruar tarifatat që shoqëritë UK rajonale do të duhet të përdorin pas agregimit. Nga ana tjetër ERRU ka qenë mjaft aktive në takime direkte me drejtorët ekzekutivë të shoqërive të veçanta dhe ato të Shoqërive UK rajonale ku janë diskutuar problematikat e procesit të agregimit dhe rrugët për zgjidhjen e tyre.

3. ERRU-ja të japë kontributin e saj dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, AMBU-në (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore), pushtetin vendor, si dhe me aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për të bërë të mundur përmirësimin rrënjësor të performancës së sektorit ujësjellës kanalizime.

Enti Rregullator i Ujit është pjesë e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas urdhrit nr. 165, datë 08.09.2022 për “ Hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri”. Ngritja e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e draft strategjisë vjen si rezultat i miratimit të vendimit Nr. 302, datë 11.05.2022 për reformën në sektorin UK, ku lind nevoja për rishikimin dhe përshtatjen e saj me kërkesat e reformës. ERRU në mënyrë konsistente është treguar i gatshëm të bashkëpunojë dhe të ndajë mendimet e tij me të gjithë aktorët në sektorin UK duke qenë promotor kryesorë i nevojës së agregimit të sektorit.

Në vijim të reformës të miratuar nga qeveria qendrore sipas VKM nr.302 datë 11.05.2022 dhe rishikimit të draft strategjisë, ERRU, ka nisur nga puna dhe do të luajë një rol kyç në përgjigje të kërkesave dhe sfidave të saj në drejtim të licencimit dhe tarifave të shoqërive UK Rajonale të krijuara.

ERRU, është duke zhvilluar një analizë të hollësishme sesi duhet të jetë strategjia dhe mundësia e tarifave që duhet të propozojnë për miratim shoqëritë rajonale pranë ERRU-së me synim dhe prioritet që ato të jenë të unifikuara për secilën shoqëri UK Rajonale. Analiza do të shoqërohet gjithashtu me konkluzione dhe rekomandime për realizimin konkret të strategjisë së mundësisë së unifikimit të tarifave me fokus përmirësimin e performancës së sektorit UK.

4. ERRU-ja në monitorimet e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në terren të kontrollojë me rigorozitet profilin e punonjësve të tyre në mënyrë që të përputhet me pozicionin e tyre të punës.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë efiçencës së stafit jo vetëm në aspektin sasiorë e cila lidhet me kostot e larta në drejtim të këtij zëri, por edhe në aspektin cilësorë duke patur parasysh përputhshmërinë e profilit të tyre me pozicionin e punës sipas detyrave specifike. Në këtë kontekst ERRU, gjatë monitorimeve të kryera në terren me shoqëritë UK e vendos fort theksin në domosdoshmërinë e përmirësimit të treguesit të efiçencës së stafit i cili trajtohet në detaje në aplikimet e shoqërive për miratimin e tarifave. Në këtë analizë ERRU e lidh numrin e punonjësve të operimit dhe mirëmbajtjes me numrin e defekteve, të profilit dhe ngarkesës së aktiviteteve të ndryshme që duhet të përmbushë shoqëria. ERRU cakton kufij të performancës së mirë, të pranueshme dhe të dobët për treguesin e efiçencës së stafit dhe sipas rastit ka dhënë rekomandime për reduktimin e punonjësve në disa funksione të cilat janë vlerësuar si të mbingarkuara me staf. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe në aplikimet e tarifave të vitit 2022 për shoqëritë UK Bulqizë, Kukës, Konispol dhe Elbasan. Në vendimet përkatëse shprehen qartë detyrat e lëna nga ERRU për këto shoqëri që duhet të realizojnë për reduktimin e stafit dhe konkretisht në çfarë sektori të tyre. Kështu për UK Kukës është kërkuar që të jepen të argumentuara të gjitha pozicionet e punës për të gjithë punonjësit në listë pagesë dhe të merret në konsideratë mundësia e reduktimit të punonjësve në pozicionin manovrator, në mënyrë që të përmirësohet efiçenca e stafit dhe rrjedhimisht të ulen edhe kostot e punës. Për UK Bulqizë, ERRU ka vlerësuar se numri aktual i punonjësve (të përhershëm dhe të nënkontraktuar) tejkalon nevojën reale për të punësuar, në këtë rast është vendosur një objektiv agresiv si dhe është rekomanduar që të reduktohet numri i punonjësve në nivele optimale, në mënyrë që në aplikimin e ardhshëm sipas Metodologjisë së Tarifave, këto kosto të quhen të justifikuar nga ERRU.

Objekivi në drejtim të përmirësimit të Efiçencës së Stafit është reflektuar edhe në vendimin përfundimtarë të miratimit të tarifave të vendosura nga ERRU dhe që duhet arritur për vitin 2023 nga shoqëritë UK të mëposhtme si në tabelën nr.6.

Tabela nr.6. Treguesi i Efiçencës së Stafit për 1000 lidhje

Nr.	Shoqëria	Treguesi i Vitit 2021	Objekivi i Vendosur nga ERRU Viti 2023
1	UK Konispol	10.5	10.4
2	UK Kukës	7.71	7.57
3	UK Bulqizë	9.9	5.9
4	UK Elbasan*	2.44	2.35

* Për UK Elbasan Treguesi i Efiçencës së Stafit është llogaritur sipas metodologjisë së re të tarifave (Staf për 1000 popullsi të shërbyer)

Gjithsesi mbas agregimit shoqëritë UK rajonale duhet të bëjnë një analizë të hollësishme në drejtim të stafit që normalisht duhet të shoqërohet me reduktim të numrit të tyre. ERRU do të ketë në fokus kryesor të vëmendjes reduktimin e stafit të tepërt të shoqërive UK rajonale kur këto do të aplikojnë për tarifa të reja pranë saj.

5. ERRU-ja të rekomandojë rishikimin e legjislacionit për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së ujësjellësve (monitorimin në distancë të objekteve me kamera) për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të stafit dhe uljen e numrit të punonjësve.

Shërbimi me personel roje fizike për garantimin e sigurisë së objekteve të sistemeve të furnizimit me ujë, si objekte të rëndësishme të veçantë, ka ndikim negativ në treguesin e efikasitetit të stafit duke ndikuar në rritjen artificiale të numrit të punonjësve dhe në të njëjtën kohë ndikon në kosto të larta për këtë shërbim. ERRU, në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar (sidomos në raportet vjetore) që të rishikohet legjislacioni për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së këtyre objekteve, si masa teknike përforcuese kundër aksesit në to, monitorimi në distancë i objekteve me kamera etj. Natyrisht kjo kërkon investime që shumë prej shoqërive ekzistuese nuk mund t'i përballonin dot financiarisht, por në kohë kjo do përkthehej në një ulje të ndjeshme të këtij zëri shpenzimesh.

Me hyrjen në fuqi të reformës, nga ana e qeverisë qendrore duhet ti jepet prioritet zgjidhjes së kësaj problematike nëpërmjet AKUM-it që të vlerësojë nevojat dhe të planifikojë fondet përkatëse për realizimin e monitorimeve dhe të sigurisë së veprave të sistemeve të furnizimit me ujë dhe KUN. Në të njëjtën kohë MIE duhet të marrë iniciativën për rishikimin e legjislacionit ligjor për të vendosur në baza konkrete dhe me kosto të arsyeshme garantimin e sigurisë së objekteve me karakter strategjik të sistemeve të furnizimit me ujë.

6. ERRU-ja të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve për mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe evidentimit të problematikave që kanë shoqëritë në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime , duke lënë rekomandime konkrete për tu realizuar nga ato.

Monitorimi i procedurave të ndjekura për trajtimin e ankesave, mekanizmat e ofruara konsumatorëve për të drejtuar ankesat e tyre si dhe zgjidhja e dhënë këtyre ankesave ka qenë pjesë e tematikave të monitorimeve të zhvilluara pranë shoqërive UK përgjatë gjithë vitit 2022. Gjatë monitorimeve, u evidentua që 15 shoqëri UK nga 26 të monitoruara kishin mangësi në hartimin e rregullores së trajtimit të ankesave në drejtim të përcaktimit të qartë të procedurave që ndiqen për zgjidhjen e tyre duke ju përshtatur llojit të ankesave. Për këtë arsye, shoqërive ju kërkua rishikimi i rregullores dhe përmirësimi i mangësive të evidentuara. Gjithashtu 11 shoqëri UK nuk ofronin disa mekanizma ankimi, informim online për konsumatorët apo zyra të dedikuara të kujdesit ndaj klientit. Edhe për këtë evidentim, duke patur parasysh edhe riorganizimin e shoqërive UK sipas reformës, ju kërkua të merrnin masa për gjetjen e mekanizmave për ofrimin e shërbimit të konsumatorëve në drejtim të trajtimit të ankesave dhe përcjelljes së informacionit mbi shërbimin UK.

7. ERRU-ja të luajë një rol pro aktiv dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e ligjit 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar” për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur në funksion të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi si dhe për riaktivizimin e grupit të punës për të bërë të mundur ndryshimet e nevojshme ligjore për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve për plotësimin e kushteve të akt miratimit të lejes higjieno – sanitare.

Gjatë vitit 2022, nuk pati zhvillime konkrete për rishikimin e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, por në kuadër të reformës sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022 për riorganizimin e sektorit UK, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u mor vendimi për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës sipas urdhrit nr. 165, datë 08.09.2022 i cituar më sipër ku përfshihet edhe rishikimi i projektligjit për sektorin UK. Në vijim të angazhimit të tij si pjesë e grupit të punës, ERRU do të japë komentet dhe rekomandimet e tij për përmirësimin e ligjit nr.8102 në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur duke patur në konsideratë kërkesat dhe zhvillimet në sektorin UK.

Gjithashtu në vijim të reformës dhe përqendrimit të vëmendjes nga ana e qeverisë qendrore në realizimin me sukses të saj, nuk pati riaktivizim të grupit të punës për të bërë të mundur ndryshimet e nevojshme ligjore për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, si pajisja me Akt Miratim Higjieno – Sanitare. Gjithsesi me hyrjen në fuqi të reformës dhe me krijimin e shoqërive UK Rajonale ku MIE/AKUM është aksionare me 51% të aksioneve pritet që kjo problematikë si pengesë për licencimin e shoqërive UK formalisht lehtësohet sepse ndërsa më parë shoqëritë UK ishin në varësi të pushteteve vendore, ndërsa Drejtoritë e Shëndetit Publik që lëshojnë Akt Miratimin Higjieno - Sanitar në varësi të qeverisë qendrore, tashmë që të dy institucionet janë në varësi të qeverisë qendrore me mundësi më të madhe koordinimi për zgjidhjen e këtij problemi. Nga ana tjetër, shoqëritë UK Rajonale të mëdha kanë mbështetjen direkte të qeverisë qendrore dhe pritet të kenë kapacitete më të mëdha financiare për të plotësuar kërkesat ndaj ISHP për pajisjen me akt miratimet higjieno sanitare. Gjithsesi është evidente nevoja e rishikimit të akteve ligjore dhe nënligjore për përfundimin e Akt Miratimit Higjieno-Sanitar në mënyrë që ato të jenë realisht garanci për mbrojtjen e shëndetit publik. ERRU prej vitesh ka qenë aktive në këtë drejtim ku ka zhvilluar shumë takime dhe i është drejtuar me shkresa zyrtare të shoqëruara me relacionet përkatëse Institucioneve përgjegjëse si MIE, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor si dhe ka vënë në dijeni Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Konkretisht me shkresën datë 19.07.2018 “Mbi nevojën për ndryshime në legjislacionin që rregullon dhënien e akt miratimit Higjieno Sanitar”, me shkresën datë 09.03.2020 “Informacion mbi problemet e Akt Miratimit Higjieno-Sanitar” dhe me shkresën datë 06.10.2021 me lëndë “Mbi eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK në lidhje me plotësimin e kushteve të Akt Miratimit Higjieno - Sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to”, e cila i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MIE për të rimarrë iniciativën për ngritjen e grupit të punës për këtë qëllim.

8. ERRU-ja në ristrukturimin e faqes zyrtare në internet, të bëjë të mundur që faqja e re të jetë më pranë konsumatorit, më e lehtë në përdorim dhe ku konsumatorët të kenë akses për komente, ankesa dhe pjesëmarrje për problematikat e ndryshme të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve që ofrohen nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve.

Me formatin e ri të website i cili është implementuar gjatë vitit 2022, ERRU ka zbatuar me përpikmëri rekomandimin e Kuvendit duke i dhënë hapësirë dhe akses sa më të lehtë përfshirjes së konsumatorëve. Përmes ristrukturimit të faqes, e cila është pasuruar me rubrika dhe anekse shtesë, konsumatorët mund të aksesojnë më lehtë në informacionin që kërkojnë. Kushdo mund të marrë informacion për pyetje apo paqartësi lidhur me shërbimin që marrin nga shoqëria përkatëse e ujësjellës kanalizimeve apo të drejtat që kanë si konsumatorë, vetëm duke shkruar në dritaren e posaçme që gjendet në ballë të faqes elektronike. Për problematika që shqetësojnë më së shumti konsumatorët, institucioni ka hartuar një listë pyetje përgjigjesh që mund t'iu vijë në ndihmë në çdo kohë. Ndërsa, për ata që kanë ankesa, ERRU, krahas dy formave tradicionale të depozitimit të ankesave si përcjellja në rrugë postare apo paraqitja pranë institucionit, ka vënë në dispozicion edhe një formular në rubrikën e posaçme dedikuar konsumatorëve.

9. ERRU-ja në vijim të studimit të bërë nga ana e saj për problematikën e mbulimit të kostove të energjisë për shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve të iniciojë një bashkëpunim AKUM-ERRU-OSHE për të kryer një analizë të thelluar të gjendjes për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike sipas një vlerësimit real të treguesve kryesorë të performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performancë bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të këtyre shoqërive.

Studimi i realizuar nga ERRU mbi problematikën e kostove të energjisë i ka paraprirë situatës të krizës energjitike që po përballlet Evropa gjatë kësaj periudhe e cila sigurisht ka ndikuar direkt edhe në rritjen e kostove të energjisë në sektorin UK duke e thelluar më tej këtë problematikë. Studimi ka konsistuar kryesisht mbi nevojën e rritjes së efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike nga shoqëritë UK, si dhe rrugëve të tjera për reduktimin e sasisë së energjisë elektrike të përdorur me anë të uljes së prodhimit të ujit duke reduktuar humbjet fizike.

ERRU në analizën e propozimeve për tarifa të shoqërive UK pranë saj i kushton vëmendje kryesore treguesit të humbjeve dhe në vendimin përfundimtar të miratimit të tarifave i vendos objektiva konkrete shoqërisë për reduktimin e tij. ERRU gjithashtu analizon gjendjen teknike të pompave të përdorura në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN, moshën e tyre si një element mjaft i rëndësishëm i rendimentit dhe konsumit të energjisë elektrike. Në rekomandimet e vendimit përfundimtar të tarifave, ERRU, thekson domosdoshmërinë e hartimit nga shoqëritë UK të planeve të rritjes së efikasitetit të energjisë të përdorur prej tyre.

Nga ana tjetër është evidente rritja e kostove të energjisë elektrike si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për sektorin e UK nga 11,5 lek/kwh, në 18,8 lek/kwh, pra që përfaqëson një rritje prej 65% të këtij çmimi, dhe një rritje të kostove të energjisë elektrike në rang sektori me rreth 38%.

Në këtë aspekt çmimi i energjisë elektrike që duhet aplikuar për shoqëritë UK është subjekt i një strategjie më të gjerë dhe komplekse që i përket qeverisë qendrore dhe institucioneve të tjera që lidhen me këtë sektor dhe që lidhet gjithashtu edhe me problemin e borxheve të trashëguara që kanë shoqëritë UK ndaj OSHEE-së. ERRU, si institucion që disponon mjaft të dhëna për sektorin në këtë drejtim ka qenë dhe është gjithnjë e gatshme të japë kontributin në mbështetje të analizave përkatëse për problemet e mësipërme.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

Një pjesë shumë të rëndësishme në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së zë edhe pjesa e Rekomandimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga qeveria qendrore për përmirësimin e performancës së sektorit të ujit. Rekomandimet vinë si rezultat i njohjes së thellë që ERRU ka për sektorin UK nga një eksperiencë mbi 20 vjeçare në rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin e mëparshëm 2021 dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i ERRU, si dhe në raportin e performancës për shoqëritë UK të vitit 2021, janë dhënë disa rekomandime të cilat rekomandohen të merren në konsideratë dhe kërkojnë mbështetjen e qeverisë qendrore, si më poshtë:

- *Duke patur parasysh problematiken për liçensimin e shoqërive UK, të fillojë procesi i ngritjes së grupit të punës për rishikimin dhe hartimin e akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Përkrahjes Sociale në bashkëpunim me MIE për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjiene Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektiveve Higjiene Sanitare për sistemet e FU dhe KUN. Hartimi i akteve të mësipërme do ti shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e riskut të ndotjes së rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit.*

Për këtë rekomandim akoma nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret nga të dy Ministrinë e mësipërme.

- *Për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike në bashkëpunim me AKUM-ERRU-OSHEE, të realizohet një analizë e thelluar e gjendjes për secilën shoqëri sipas një vlerësimi real të Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos të UPA, Normës Korrente të Arkëtimit dhe Efiçencës së Stafit dhe të përmirësimit të treguesit të Efiçencës së Energjisë Elektrike.*

Gjatë viti 2022, vëmendja e qeverisë qendrore ka qenë e fokusuar në reformën e agregimit të sektorit. Problematika e mësipërme do të jetë pjesë e planeve për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK të agreguara në nivel strategjik kombëtar të çmimeve të energjisë elektrike, që të gjitha kostot operationale do të jenë me vetëfinansim ose të kombinuara me subvencione etj.

- *Në kuadër të nismës së qeverisë qendrore të ndërmarrë gjatë vitit 2021 mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të efiçencës operationale dhe qëndrueshmërisë financiare, të vijohet sa më parë me konkretizimin e këtij procesi sa i përket formës dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore që janë parashikuar për realizimin e saj.*

Gjatë vitit 2022, qeveria qendrore ndërmori hapat e duhura për të konkretizuar reformën në sektorin e ujit duke e agreguar sektorin nga 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë në 61 bashki të vendit në 15 Shoqëri UK Rajonale. Për këtë, në maj 2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 302, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Në detaje shih më poshtë në pikën 4, “Reforma në Sektorin UK sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022”

Aktualisht ka përfunduar procesi ligjor i rajonalizimit për 12 shoqëri UK rajonale nga 15 që parashikohet në VKM-në e mësipërme. Pritet të përfundojë rajonalizimi gjithashtu për shoqëritë e agreguara UK Shkodër SKP, UK Tiranë SKP dhe UK Vlorë SKP, të cilat akoma janë në proces sqarimi të bashkive përkatëse me MIE të disa kushteve specifike që kanë këto rajone.

- *Për rritjen e efikasitetit të ERRU-së në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit të UK në vend, si dhe në përgjigje të kërkesave të kohës për sektorin dhe të ndryshimeve klimatike, të mbështetet rishikimi i ligjit nr. 8102 për rregullimin e sektorit.*

Gjatë vitit 2022, nuk pati zhvillime konkrete për rishikimin e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN”, i ndryshuar, por në kuadër të reformës sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022 për riorganizimin e sektorit UK, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u mor vendimi për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës sipas urdhrit nr. 165, datë 08.09.2022 i citar më sipër ku përfshihet edhe rishikimi i projektligjit për sektorin UK. Në vijim të angazhimit të tij si pjesë e grupit të punës, ERRU do të japë komentet dhe rekomandimet e tij për përmirësimin e ligjit nr.8102 në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur duke patur në konsideratë kërkesat dhe zhvillimet në sektorin UK.

- *Në lidhje me problemin e garantimit të sigurisë së veprave të furnizimit me ujë si objekte të rëndësishme të veçantë duhet përshtatur legjislacioni në fuqi për të mundësuar alternativën e garantimit të sigurisë me mjete logjistike, si kamera të gërshetuara edhe me masa të tjera teknike, në mënyrë që të ulen kostot e pajustificuara të stafit, apo të kontraktimit të palëve të treta për këto shërbime.*

Akoma nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim. Me hyrjen në fuqi të reformës, mendohet që do të merret në konsideratë nga ana e qeverisë qendrore zgjidhja e kësaj problematike nëpërmjet AKUM-it, si edhe MIE duhet të marrë iniciativën për rishikimin e legjislacionit ligjor për të vendosur në baza konkrete dhe me kosto të arsyeshme garantimin e sigurisë së objekteve me karakter strategjik të sistemeve të furnizimit me ujë.

- *Ujit Pa të Ardhura, 64.8% megjithëse ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2020, përsëri mbetet problem serioz për sektorin UK dhe me elementë të konsiderueshme të pasaktësisë së matjes së sasisë së ujit të prodhuar dhe më tej. Në kuadër të reformës së re të sektorit UK, vëmendje e veçantë duhet të kushtohet instalimit të matësve të ujit në burim dhe tek konsumatorët privat dhe familjarë në mënyrë që të hartohen bilanci e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.*

Financimi i ujëmatësve të mëdhenj në burim, dhe pajisja 100% me ujëmatësa individuale e konsumatorëve është një proces i vazhdueshëm që realizohet nga qeveria qendrore me anë të AKUM-it, por që i duhet kushtuar një vëmendje e shtuar sidomos për ujëmatësit e mëdhenj.

- *Planet e Biznesit 5-vjeçarë si dhe Planet e Menaxhimit të Aseteve si një domosdoshmëri për shoqëritë UK, duhet të jenë në fokus kryesorë të reformës në sektor për shoqëritë e agreguara.*

Hartimi i Planeve 5 Vjeçare nga shoqëritë UK rajonale është pjesë dhe në fokus të reformës në sektor.

4 Reforma në Sektorin UK sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022

Viti 2022 konsiderohet si viti i fillimit të një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri e cila e agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale, nga një sektor më parë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i këtij procesi është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Në maj 2022, nga Këshilli i Ministrave u miratua vendimi nr. 302, *“Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”* i cili në mënyrë të përmbledhur parashikon si më poshtë:

- Riorganizimi i shoqërive UK si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKP-UK) do të kryhet nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja aksionare me dy nivele administrimi në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, i ndryshuar.
- Njësitë e qeverisjes vendore që bien dakord për themelimin e SKP-UK-së së re do të ndjekin statutin e modelit standard që shërbejnë si akte themelore për themelimin e SKP-UK-së. SKP-UK do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat e shërbimit sipas hartës territoriale, të miratuar nga AKUM.
- SKP-UK-ja e themeluar do të ketë në asamblenë e aksionarëve përfaqësues të qeverisë qendrore MIE, e cila do të mbajë të paktën 51% të aksioneve. Pjesa e mbetur prej 49% do llogaritet në raport me numrin e klientëve aktivë që kanë shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë rajonale UK.
- SKP-UK-të e krijuara janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktuale, kontratat e shërbimeve, si dhe çdo të drejtë që rrjedhin prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ish-njësive të qeverisjes vendore, me institucionet financiare ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, do të ndajë të gjitha fondet e planifikuara për investime nga buxheti i shtetit apo institucionet financiare ndërkombëtare vetëm përmes SKP-UK-së së re.
- Bashkitë që bien dakord të marrin pjesë në procesin e riorganizimit, duhet të miratojnë dhe të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm të kërkuar nga ligjet në fuqi për të vazhduar me transferimin e aktivitetit aktual të ndërmarrjes së ujësjellësit tek SKP-UK dhe do të procedojnë sipas dispozitave të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në përputhje me riorganizimin dhe planin kombëtar të hartuar nga AKUM.
- SKP-UK i ri i krijuar nga riorganizimi në përputhje me hartën e ndarjes territoriale të hartuar nga AKUM, brenda tre muajve nga miratimi i Prefektit të Qarkut, do të aplikojë për marrjen e licencës së re për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU).

- Transferimi i aktivitetit do të bazohet në një kontratë të noterizuar (marrëveshje transferimi) që do të nënshkruhet ndërmjet palëve (transferuesit dhe marrësi i transfertës) e cila do të regjistrohet në pasqyrat financiare të Shoqërive të reja.

Në Aneks 2, jepet harta e ndarjes territoriale sipas 15 shoqërive UK Rajonale që do të krijohen pas reformës në sektorin UK bazuar në ndarjen territoriale aktuale me 61 bashki.

Procesi i riorganizimit sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022 për agregimin e sektorit po ecën me ritme të shpejta duke u ndjekur me shumë intensitet nga AKUM si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij procesi. Kjo konstatohet edhe nga fakti se deri në mbyllje të vitit 2022 janë arritur marrëveshjet e transferimit të aktivitetit të shërbimeve UK ndërmjet 50 bashkive dhe si rrjedhojë janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës. Shoqëritë e reja Rajonale të krijuara janë **UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Dibër, UK Kukës, UK Berat, UK Elbasan, UK Gjirokastrë, UK Fier, UK Lushnje dhe UK Sarandë**. Deri në mbyllje të vitit 2022 vetëm 2 shoqëri UK Rajonale përkatësisht UK Korçë dhe UK Pogradec e kanë filluar ushtrimin e aktivitetit me 1 nëntor 2022. Pjesa tjetër e shoqërive UK Rajonale të krijuara do të fillojnë ushtrimin e aktivitetit me 1 janar 2023 me përjashtim të shoqërisë Rajonale UK Sarandë e cila ka planifikuar fillimin e ushtrimit të aktivitetit në 1 Mars 2023 për shkak të vonesave me nënshkrimin e marrëveshjes me shoqërinë UK Finiq.

Janë akoma 11 bashki të cilat sipas parashikimeve të reformës në sektor përbëjnë 3 shoqëri UK Rajonale përkatësisht **UK Shkodër** e cila përfshinë bashkitë (Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë) **UK Tiranë** e cila përfshinë bashkitë (Tiranë, Kamëz, Vorë) dhe **UK Vlorë** e cila përfshinë bashkitë (Vlorë, Selenicë, Himarë) që nuk kanë arritur të kryejnë marrëveshjet e bashkëpunimit edhe pse nga ana këshillave bashkiake të këtyre bashkive janë marrë vendimet përkatëse të cilat autorizojnë kryetarët e bashkive për të nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me MIE dhe më pas transferimit drejt shoqërisë UK Rajonale. Vonesat në krijimin e këtyre 3-shoqërive UK Rajonale brenda vitit 2022 sipas parashikimeve të VKM nr.302, vijnë si rezultat i diskutimeve në vazhdim për pika të veçanta të procesit ndërmjet drejtuesve të pushteteve vendore dhe MIE.

Në aneks 4 jepet situata e ecursisë së reformës në vijim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 sipas hapave që duhen ndjekur deri në krijimin e shoqërisë së re SKP-UK Rajonale dhe fillimin e aktivitetit të saj.

ERRU, në vijim të reformës dhe hapave që duhen ndjekur për konkretizimin e saj, ka luajtur një rol proaktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme në drejtim të licencave dhe tarifave të cilat i shërbejnë përshpejtimin dhe ecursisë së këtij procesi. Kështu KKRR me vendimin Nr. 420, datë, 29.09.2022 *“Për licencat dhe tarifën e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”*, ka lehtësuar ecurinë e këtij procesi i cili në pikën 1 dhe 3 të tij shprehet si më poshtë:

- 1) *Shoqërive ujësjellës-kanalizime të cilat janë të pajisura me licencë nga ERRU për operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, dhe kanë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”,*

ERRU u jep të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta.

- 2) ***Shoqëritë SKP-UK do të përdorin tarifatat aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU, deri në miratimin e tyre, nga Komisioni Kombëtar Rregullator. SKP mbas marrjes së licencës nga ERRU, paraqet aplikimin për rishikimin dhe miratimin e tarifave, që do të kryhet bazuar në të dhënat e një viti ushtrimor të aktivitetit të shoqërisë SKP. Procedurat për miratimin e tyre do të kryhen në përputhje me nenin 22 të ligjit 8102 datë 28.03.1996 " Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime".***

Të dy vendimet e mësipërme ERRU i ka ndërmarrë si institucion i ngarkuar nga VKM nr. 302 e mësipërme për zbatimin e saj, të cilat kanë patur si qëllim eliminimin e një burokracie që mund të mënjanohet për të përshpejtuar sa më shumë ecurinë e zbatimit të reformës dhe njëkohësisht të respektohet legjislacioni në fuqi për proceset e licencimit dhe të miratimit të tarifave të shoqërive UK SKP nga ERRU.

ERRU ka zhvilluar edhe një sërë takimesh të drejtpërdrejta me drejtuesit e rinj të shoqërive UK Rajonale të krijuara dhe kryetarët e këshillave mbikëqyrëse, me qëllim informimin e tyre mbi hapat që duhen ndjekur në zbatim të reformës sipas VKM nr. 302 duke patur në konsideratë zbatimin e ligjit të ERRU-së nr. 8102 gjatë kësaj periudhe tranzitore. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan gjithashtu edhe një sërë problematikash me të cilat po përballen shoqëritë e reja UK rajonale gjatë kësaj faze fillestare të shprehura si më poshtë:

- *mungesë e dokumentacioneve të rregullta nga shoqëritë UK Ekzistuese*
- *mungesë të sistemeve të informacionit dhe si rrjedhojë vështirësi për hedhjen e të dhënave*
- *diferenca të klientëve debitorë në sistem me ato të pasqyruara në bilancet financiare*
- *probleme me data basen e klientëve, nuk ka të dhëna të sakta për emrat dhe adresat*
- *mungesa të makinerive dhe mjeteve kryesish eskavator, pasi ka probleme për zhvendosjen e tyre në distanca të mëdha*

Një tjetër element shqetësues për shoqëritë UK Rajonale, janë edhe indikatorët e performancës të vendosura nga AKUM për vitin 2023 të cilat jenë të unifikuara për të gjitha shoqëritë UK Rajonale dhe në disa raste janë shumë optimiste për tu arritur. Kjo nisur nga fakti se disa shoqëri UK që janë bërë pjesë e shoqërive UK Rajonale nuk kanë patur performancë të kënaqshme duke influencuar kështu negativisht në performancën e përgjithshme të shoqërisë së re. Kjo sigurisht kërkon një rishikim të objektivave të performancës të vendosura për shoqëritë UK Rajonale të cilat duhen studiuar dhe vendosur rast pas rasti në mënyrë që të jenë të bëshme dhe të arritshme për tu realizuar nga ana e tyre duke patur në konsideratë të gjithë problematikat e hasura gjatë këtij procesi.

Agregimi i sektorit është një proces kompleks i cili gjatë zbatimit të tij në terren has shumë sfida dhe të panjohura të cilat kërkojnë vëmendje nga qeveria qendrore në drejtim të manaxhimit të aseteve ekzistuese dhe planifikimit sa më të drejtë të investimeve të nevojshme që duhen kryer për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve si synimi final i këtij procesi.

5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2023

- Të jetë proaktive duke ndjekur nga afër procesin e riorganizimit të sektorit sipas parashikimeve të reformës në mbështetje të realizimit të objektivave përkatëse për realizimin e saj dhe për përmirësimin e performancës së sektorit duke dhënë kontributin e tij në zbatim të VKM nr.302 dhe ligjit funksional të ERRU-së nr.8102.
- Duke qenë pjesë e grupit ndërinstitucional të punës të ngritur nga MIE sipas urdhrit nr. 165, datë 08.09.2022 për “Hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri”, të ndikojë në rishikimin e ligjit nr. 8102 duke patur parasysh forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.
- Të angazhohet në nxitjen direkte për licencimin sa më parë të të gjitha shoqërive UK Rajonale të krijuara bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përfshirë dhe situatën e licencimit për shoqëritë UK Ekzistuese që mbeten pa u riorganizuar sipas VKM nr.302 datë 11.05.2022.
- Të ofrojë asistencën e duhur për shoqëritë rajonale në lidhje me problematikat që në mjaft raste priten të hasen nga propozimet e tarifave të reja duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.
- Të shtojë vëmendjen dhe kontrollin ndaj shoqërive UK për rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave si një ndër problematikat kryesore të sektorit, si dhe në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm në terren të shoqërive UK Rajonale dhe atyre të pa agreguara me qëllim nxitjen e tyre për arritjen e treguesve kryesorë të performancës.
- Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK mbi procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime për tu realizuar nga ato.
- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me rregullatorët e Ballkanit Perëndimor, Evropianë WAREG dhe veçanërisht me Rregullatorin e Italisë ARERA dhe Hungarisë MEHK, të shfrytëzojë mundësitë e rritjes profesionale të stafit përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave me to dhe ato bashkëkohore.
- Të vijojë të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit, veçanërisht Shoqatën e Shoqërive UK, SHUKALB në mbështetje të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të Acquis Communautaire të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN.

6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2022

Pjesë e raportit vjetor të aktivitetit të ERRU-së është ecuria e Performancës së Sektorit të Ujësjiellës Kanalizimeve për vitin 2022. Të dhënat e raportuara në ERRU për këtë raport konsiderohen paraprake, por afër atyre që priten të certifikohen nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar deri në fund të muajit mars 2022, kohë kur realizohet edhe mbyllja e bilanceve financiare nga shoqëritë UK.

Gjendja e performancës së sektorit UK për vitin 2022 e pasqyruar sipas raportimeve të kryera nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor, do të jetë e fundit që realizohet bazuar në të dhënat e këtyre 58 shoqërive, pasi në vijim të reformës sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022, duke filluar nga janari i vitit 2023, në sektor do të operojnë kryesisht shoqëri UK Rajonale. Kjo sigurisht do të kërkojë dhe një ri konceptim tjetër analize krahasimore e cila do të pasqyrohet në raportin e performancës së sektorit UK për vitin 2023.

Theksohet fakti se grumbullimi i të dhënave të vitit 2022 në këtë moment, ka qenë një sfidë për ERRU-në dhe shoqëritë raportuese për shkak të riorganizimit të sektorit, pasi stafet e shoqërive UK ekzistuese që janë bërë pjesë e shoqërive UK Rajonale, kanë qenë të impenjuara njëkohësisht në disa drejtime në zbatim të detyrave dhe afateve të përcaktuara sipas VKM-së, të cilat duhet të mbyllnin brenda muajit janar 2023. Gjithsesi një analizë e plotë e performancës së sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie UK në veçanti, do të jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet çdo vit nga ERRU në fund të Qershorit të vitit pasardhës pasi disponohen të dhëna të plota vjetore të certifikuara për shoqëritë UK. Në këtë rast të dhënat e shoqërive ridërgohen përsëri pranë ERRU-së, pasi janë rakorduar me pasqyrat financiare të certifikuara nga ekspertët kontabël të autorizuar.

ERRU, monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e shoqërive UK, duke pasur në fokus të veçantë sidomos shoqëritë që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU vitet e fundit për të cilat janë vendosur edhe objektiva që duhen arritur prej tyre. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Në vijim të miratimit të metodologjisë së re të tarifave në dhjetor të vitit 2021, është realizuar edhe rishikimi i treguesve të performancës ku janë përfshirë edhe dy tregues të rinj ***“Efiçenca e Energjisë”*** dhe ***“Ankesat e Konsumatorëve”***, por duke qenë se janë raportuar për herë të parë, për në nivel krahasimor nuk mund të merren në analizë për vitin 2022.

Në tabelën 7 të mëposhtme, jepen nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2022 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2021 duke përfshirë dhe dy treguesit e rinj të mësipërm. Në Aneks 6, jepen gjithashtu treguesit e performancës për secilën shoqëri në vete dhe sipas grupeve të klasifikuara për këtë qëllim.

Tabela nr. 7. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2021-2022

Nr.	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2021	Viti 2022	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	64.8	63.4	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	103.4	90.5	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	77.6	78.6	↗
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	92.3	94.7	↗
5	Niveli i Matjes	%	80.7	82.8	↗
6	Efiçenca e Stafit	(stafi/1000 lidhje UK)	4.9	4.66	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	15.4	16.3	↗
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.8	78	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	52	54.4	↗
10	Efiçenca e Energjisë FU*	Kwh/m³	n/a	0.69	-
11	Ankesat e Klientëve*	%	n/a	2.92	-

Burimi: ERRU

** Tregues të vendosur për tu marrë në analizë për herë të parë gjatë vitit 2022.*

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2022 paraqiten të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesit financiar Mbulimi i Kostove O&M, i cili ka një rënie të ndjeshme me 12.9% dhe që lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

Treguesit e përmirësuar për vitin 2022, lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimin e mirë të shoqërive UK, si rritja e Normës së Arkëtimit Korrente dhe e Përgjithshme, Nivelit të Matjes, Mbulimi me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, tregues këto që kanë ndikuar edhe në përmirësimin e Ujit Pa të Ardhura.

Megjithëse, shoqëritë UK në përgjithësi kanë punuar mirë në drejtim të menaxhimit, si në uljen e prodhimit, rritjen e faturimit, arkëtimet korrente dhe të debive të prapambetura si dhe në uljen e numrit të konsumatorëve pa matës, nuk kanë arritur të ruajnë një performancë të mirë financiare. Kjo si rezultat i krizës globale të energjisë elektrike, e cila ka shënuar dhe rritjen më të madhe në zërin e kostove të shoqërive UK për vitin 2022 në nivelin 38% krahasuar me një vit më parë, duke ndikuar më pas në rritjen e të gjitha kostove O&M, e reflektuar edhe në përkeqësimin e këtij treguesi për sektorin në tërësi.

Më poshtë jepet në mënyrë të përmbledhur analiza e ecurisë për secilin tregues kryesor të performancës.

"Uji Pa të Ardhura" i cili është një nga treguesit më të rëndësishëm që ndikon në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, për vitin 2022 është përmirësuar me rreth 1.4% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 64.8% në 63,4%. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së volumit të ujit të faturuar me rreth 2.7 milion m³ përkundrejt volumit të prodhuar, i cili është ulur me 11.3 milion m³ gjatë vitit 2022. Ndikimi pozitiv në rritjen e volumit të ujit të faturuar ka ardhur kryesisht nga shoqëritë UK Tiranë me rreth 1.2 milion m³ dhe UK Kavajë me rreth 820 mijë m³, të faturuar më shumë të cilat së bashku kanë një rritje të volumit të ujit të faturuar me rreth 2 milion m³. Për UK Tiranë, rritja e volumit të faturuar ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të klientëve me rreth +5821, ndërsa për UK Kavajë, ka ardhur si rezultat i aksionit task forcë të ndërmarrë në muajin qershor nga AKUM në bashkëpunim me UK Kavajë si dhe nga rritja e sasisë së ujit të faturuar me shumicë e

cila është reflektuar në rritjen e volumit të faturuar në të gjithë kategoritë e klientëve për këtë shoqëri. Ndërsa, në uljen e sasisë së ujit të prodhuar ndikim pozitiv kanë patur shoqëritë UK Berat - Kuçovë, UK Durrës, UK Elbasan, UK Fier, UK Mallakastër, UK Tiranë, ku secila prej tyre e ka ulur me mbi 1 milion m³ ujë prodhimin për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Megjithëse këto shoqëri e kanë ulur prodhimin e ujit, performanca e tyre në drejtim të kohëzgjatjes mesatare të furnizimit me ujë ka mbetur e njëjtë me vitin paraardhës duke mos ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

Gjithsesi, për vitin 2022 edhe pse i përmirësuar, ky tregues mbetet përsëri në nivele të larta 63.4%. Objektivi kryesor dhe detyrues për shoqëritë UK është vendosja fillimisht e matësave në burim, për një përcaktim më të saktë të sasisë së ujit të prodhuar, plotësimi 100% i klientëve me matësa individualë, zbulimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj dhe rrija e faturimit.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është një tregues i performancës financiare i cili paraqet nivelin e menaxhimit të kostove dhe të ardhurave nga shoqëritë UK. Në të përfshihen vetëm kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe përjashtohen kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare. Për shkak të krizës ekonomike dhe të rritjes së çmimeve, Mbulimi i Kostos së Operim Mirëmbajtjes për vitin 2022, ka rënë ndjeshëm nga 103.4% në 90.5%.

Gjatë vitit 2022 kanë zhvilluar aktivitetin e tyre 58 shoqëri, nga të cilat 13 prej tyre kanë performancë financiare të mirë dhe arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M, 18 shoqëri kanë performancë të pranueshme në nivelin 73.5% deri 100% të këtij treguesi dhe 27 shoqëri performojnë dobët nën nivelin 70% të këtij treguesi që paraqesin vështirësi të mëdha në zhvillimin normal të aktivitetit operativ. Mbulimi i Kostove Totale, në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare, për vitin 2022, arrihet nga tre shoqëri UK në sektor, përkatësisht UK Tiranë, UK Dibër dhe UK Librazhd. Në detaje kostot për sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve jepen në tabelën 8 të mëposhtme.

Tabela nr.8. Ecuria e Kostove dhe të Ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca
	<i>Kostot e Shërbimit UK</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	4,521,714	4,852,202	230,488
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,799,804	3,883,693	1,083,889
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	439,757	540,579	100,822
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	685,350	642,867	(42,483)
5	Kosto e materialeve	265,968	284,638	18,670
6	Kosto të tjera	947,889	1,099,794	151,905
	<i>Kostot Operim & Mirëmbajtjes</i>	<i>9,660,482</i>	<i>11,203,773</i>	<i>1,543,291</i>
1	Kostot e amortizimit	3,021,227	2,824,923	(196,304)
2	Kostot financiare taksa tatime	841,664	821,741	(19,923)
	<i>Kostot Totale</i>	<i>13,523,374</i>	<i>14,850,437</i>	<i>1,327,063</i>
	<i>Të Ardhurat:</i>			
1	Nga shërbimet UK	9,511,193	9,847,859	336,686
2	Të ardhura të tjera lidhje, rilidhje etj.	476,334	293,466	(182,868)
	<i>Të Ardhurat Totale</i>	<i>9,987,507</i>	<i>10,141,325</i>	<i>153,818</i>
	<i>Niveli i Mbulimit të Kostove</i>			
	<i>Mbulimi i Kostove të O & M</i>	<i>103.39%</i>	<i>90.52%</i>	<i>-12.87%</i>
	<i>Mbulimi i Kostove Totale</i>	<i>73.85%</i>	<i>68.29%</i>	<i>-5.56%</i>

Sipas të dhënave konstatohet se, për vitin 2022, shoqëritë UK kanë zhvilluar aktivitetin e tyre me kosto operative rreth 16% më të lartë se në vitin 2021 (+1.5 miliard lekë), ndërkohë që të ardhurat në sektor janë rritur vetëm me 1.5% krahasuar me vitin paraardhës (+154 milion lekë) duke dhënë një performancë financiare në rënie sa i përket nivelit të mbulimit të kostove.

Për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, konstatohet se, kostot me rritjen më të madhe janë kostot e energjisë elektrike me 38% rritje (+1.1 miliard lekë), kostot e punës me 5% rritje (+230 milion lekë), kostot e tjera operative (+152 milion lekë), kostot e riparimeve (+101 milion lekë) dhe kostot e kimikateve me një rritje më të lehtë si rezultat i rritjes së përgjithshme të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve.

Kostot e Energjisë janë rritur ndjeshëm për shkak të rritjes së çmimit për njësi të energjisë elektrike nga ERRE nga 11,5 lek/kwh në 18,8 lek/kwh që kanë filluar nga 1 janari 2022. Ndikim të konsiderueshëm (+521 milion lekë) në rritjen e kostove të energjisë së sektorit, ka dhënë UK Durrës, duke qenë se kostot e energjisë për këtë shoqëri zënë rreth 36% të kostove të energjisë në sektor.

I vetmi faktor për rritjen e kostove të energjisë elektrike është rritja e çmimit për njësi, pasi vëllimi i ujit të prodhuar në sektor ka rënë duke sjellë rënie të konsumit të energjisë elektrike (-3 milion kw). Prandaj konstatohet se 70% e rritjes së kostove të operim mirëmbajtjes ka ardhur si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë.

Një rritje e këtij niveli të çmimit për njësi të një prej zërave më të rëndësishëm të kostove të aktivitetit UK, duhet të reflektohej në rritje të nivelit të tarifave për shërbimet e ofruara, por koha e shkurtër në dispozicion, paqartësia në ecurinë e çmimeve në treg, si edhe i ndryshimeve klimatike, akoma nuk ka bërë të mundur të përcaktohet përfundimisht në nivel qendror politika për çmimin e energjisë elektrike për sektorin e UK. Rrjedhimisht subvencionimi i shoqërive ka qenë i nevojshëm edhe për vitin 2022. Ndryshimet në kostot e energjisë elektrike të shoqërive UK, nuk kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për aplikim tarifor, për shkak edhe të procesit të riorganizimit të sektorit sipas Vendimit nr.302 datë 11.05.2022, por pritet që pas përfundimit të procedurave të ketë një fluks të aplikimeve për tarifa të rregulluara për shoqëritë rajonale të reja të formuara.

Kostot e Punës janë rritur për shkak të rritjes së nivelit të pagës minimale dy herë brenda vitit 2022, përkatësisht në prill nga 30.000 lekë në 32.000 lekë dhe në shtator në 34.000 lekë. Numri i punonjësve në sektor ka rënë me 88 punonjës dhe kjo reflektohet edhe në përmirësimin e treguesit të efikasitetit të stafit. Pritet që me riorganizimin e sektorit numri i punonjësve të reduktohet më tej sidomos stafi administrativ.

Kostot e Riparimeve kanë rezultuar gjithashtu në rritje për vitin 2022 për shkak edhe të rritjes së numrit të defekteve në rrjetin shpërndarës, por edhe për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe shërbimeve gjatë këtij viti.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara janë në rënie për të dytin vit radhazi, ndikimin kryesor konstatohet se e ka dhënë përsëri shoqëria UK Tiranë, duke qenë se përbën pjesën më të madhe të kostove të shërbimeve të kontraktuara në sektor. Në këto kosto peshën më të madhe e zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private.

Shoqëritë UK që investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera operojnë me kosto të reduktuar lidhur me kostot e shërbimeve për roje, eksperiencë që duhet ndjekur nga të gjitha shoqëritë në sektor, por që duhet të përbëjë edhe një nga prioritetet e investimeve në sektor.

Kostot të Tjera Operacionale Përfshihen kostot e qerave për zyrat, vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve Ujore etj. Ky zë shpenzimesh raportohet me rritje prej 152 milion lekë krahasuar me vitin 2021 për shkak të rritjes së çmimeve në vitin 2022.

Kostot Kapitale përfshijnë kostot e amortizimit të cilat kanë rënë me (-196 milion lekë) për shkak se edhe investimet janë në proces dhe nuk i kanë ngarkuar ende llogaritë e aktiveve, ndërsa kostot financiare rezultojnë të ulura me (-20 milion lekë). Megjithëse Kostot Kapitale janë reduktuar në total me (-216 milion lekë), ndryshimet e mëdha të kostove operative kanë sjellë përkeqësim të treguesit të Mbulimi të Kostove Totale me -5.6%.

Të Ardhurat nga Aktiviteti i UK për vitin 2022 janë rritur me 1.5% (+153.8 milion lekë), e cila ka ardhur kryesisht nga influenza e rritjes së numrit të lidhjeve të reja +23,601 lidhje të reja FU dhe +14,778 lidhje të reja KUN, që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të faturimit (me +337 milion lekë). *Volumi i ujit të faturuar për sektorin UK, është rritur me 2.7 milion m³ edhe për shkak se disa shoqëri kanë përmirësuar treguesin e vazhdimësisë së furnizimit me ujë në krahasim me vitin paraardhës 2021.*

Sic theksohet më sipër këto raportime janë paraprake dhe një analizë e detajuar e treguesve të Mbulimit të Kostove O&M dhe të Kostove Totale për vitin 2022, do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK i cili publikohet në fund të muajit qershor 2023. Në këtë raport realizohet verifikimi dhe rakordimi i të dhënave duke ju referuar Bilanceve Kontabël të certifikuara nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

"Norma e Arkëtimit" është gjithashtu tregues i performancës financiare të sektorit UK, e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive dhe me aftësinë paguese të tyre. ERRU monitoron dy tregues, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK), por që duhet të jenë në vëmendjen kryesore të vetë shoqërive UK. Shoqëritë duhet të rrisin raportin aktual të arkëtimit dhe të ulin periudhat e arkëtimit të debive. NAP në përlllogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, përfshirë edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK i përjashton këto të fundit.

Norma e Arkëtimit Korrente për sektorin UK në vitin 2022 rezulton të jetë përmirësuar në 78.6% nga 77.6% që ishte në vitin 2021. Ndër shoqëritë me performancë të mirë krahasuar me vitin 2021, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e këtij treguesi mund të përmendim UK Librazhd, Tepelenë, Dibër, Fushë Arrëz, Delvinë, Dropull, Ersekë, Has, Durrës, Vlorë, Tiranë etj.

Gjithashtu, Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2022, paraqitet e përmirësuar me 2.4% në 94.7% nga 92.3% në vitin 2021. Kjo tregon se shoqëritë kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së debive të prapambetura, ku shpesh herë nga ana e tyre përdoret alternativa e lidhjes së akt marrëveshjeve me debitorët për shlyerjen e borxheve me këste. Shoqëritë me një performancë të përmirësuar për normën e përgjithshme të arkëtimit, krahasuar me vitin 2021, janë UK Vau Dejës, UK

Gjirokastrë, UK Himarë, UK Krujë, UK Peqin, UK Rrogozhinë, UK Vlorë, UK Selenicë, UK Durrës, UK Lushnje, UK Kamëz, UK Lezhë. etj.

Përveç shoqërive që kanë ndikuar në mbajtjen e një norme të qëndrueshme të përgjithshme të arkëtimit, në sektor ka shumë shoqëri që kanë arkëtuar më pak debi të vjetra krahasuar me vitin e mëparshëm 2021, si: UK Kavajë, UK Devoll, UK Kukës, UK Patos, UK Këlcyrë, UK Përmet, UK Maliq, UK Bulqizë dhe UK Poliçan. Gjithsesi, një pasqyrë më e saktë e këtij treguesi do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2022 pasi të jenë bërë rakordimet me bilancet financiare të certifikuara për secilën shoqëri UK.

Ndër arsyt kryesore, që ka influencuar në uljen e nivelit mesatar të arkëtimit në sektor ka qenë edhe ulja e fuqisë paguese të klientëve për shkak të rritjes së përgjithshme të nivelit të çmimeve, si dhe dhënia prioritet e arkëtimit të debive të vjetra.

"Niveli i Matjes" si tregues lidhet me faturimin në përputhje me konsumin real të klientëve të shoqërive UK, tregues i cili rezulton në përmirësim të vazhdueshëm. Për vitin 2022, ky tregues në sektor rezulton 82.8% i përmirësuar me 2.1% krahasuar me vitin paraardhës.

Gjatë vitit 2022, në sektor janë instaluar rreth 23,601 matës uji, por ende raportohen 162,421 klientë pa matës nga të cilët 6,618 janë të kategorisë jo familjarë. Referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007, klientët jo familjarë (subjektet private) detyrohen që të instalojnë ujëmatës me shpenzimet e tyre, por akoma ky vendim nuk është zbatuar plotësisht nga ana e shoqërive UK për këtë kategori klientësh. Shoqëritë UK duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, pasi faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale e cila jep me pas impakt negativ edhe në treguesin e Uji Pa të Ardhura. Në vijim të reformës pajisja e të gjithë klientëve me matës, duhet të jetë prioritet i shoqërive UK Rajonale në mënyrë që ti jepet fund abuzimit nga klientët e papërgjegjshëm dhe në të njëjtën kohë mbron konsumatorët e rregullt.

"Eficienca e Stafit" është një tregues shumë i rëndësishëm pasi lidhet direkt me kostot e punës, të cilat së bashku me energjinë elektrike zënë peshën kryesore ndaj totalit të kostove të operimit të shoqërisë. Viti 2022, është viti i parë ku ky tregues krahasohet me vitin paraardhës 2021 duke marrë në konsideratë vetëm punonjësit sipas organogramës së shoqërive UK pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar me subjektet private. Ky tregues luhetet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK.

Treguesi i efijencës së stafit për vitin 2022, ka një përmirësim të lehtë dhe rezulton në nivelin e 4.66 punonjës për 1000 lidhje UK nga 4.9 punonjës për 1000 lidhje që ishte në vitin paraardhës. Përmirësimi i lehtë i efijencës së stafit për vitin 2022, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 23,601 lidhje dhe atyre me kanalizime me rreth 14,778 lidhje, dhe nga ana tjetër stafi është reduktuar me 88 punonjës.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë analizës së këtij treguesi duke analizuar punonjësit sipas organogramës së shoqërisë e cila është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi.

ERRU, ka theksuar se në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje të komponentëve

të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh, shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte, kjo krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Efijencës së Stafit. Gjithashtu evident mbetet fakti i punësimeve mbi nevojat e shoqërisë për arsye të ndryshme të pajustificuara.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është një tregues i rëndësishëm i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve që shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë. Ky tregues ka patur ecuri pozitive nga viti në vit dhe për vitin 2022 raportohet mesatarisht në nivelin e 16.3 orë/ditë me një përmirësim prej rreth 1 orë krahasuar me vitin 2021. Në mbyllje të vitit, rezultoni se në sektor operojnë 11 shoqëri UK që kanë furnizim të pandërprerë 24/7 ndërsa pjesa dominuese e shoqërive rreth 33 prej tyre ofrojnë furnizimin me ujë në nivele relativisht të mira 10-22 orë në ditë.

Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e kryera në sektor ku rritja e orëve të furnizimit me ujë 24/7 është edhe objektivi afatshkurtër i qeverisë qendrore 2018-2023. Projekt ky që fillimisht ka filluar me qendrat urbane, ku është parashikuar ofrimi i shërbimi të furnizimit me ujë 24 orë për 58 nga 66 qendra urbane, deri në fund të vitit 2023. Në mbyllje të vitit 2022 si rezultat i investimeve të kryera nga AKUM u arrit një regjim furnizim me ujë pa ndërprerje (24/7 orë) për 27 qendra urbane të cilat do jepen të detajuara sipas zonave, në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2022 që publikohet në fund të muajit qershor.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2022 ka një përmirësim me rreth 1.2% dhe është në nivelin e 78% nga 76.8% që ishte në vitin 2021. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i shtimit të popullsisë së juridiksionit me vetëm 4,212 banorë ndërsa ajo e shërbyer është shtuar me rreth 57,052 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë UK Tiranë, UK Durrës UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë dhe UK Kavajë të cilat kanë raportuar shtim të numrit të popullsisë në zonën e shërbimit krahasuar me vitin paraardhës. Disa shoqëri UK, si Gramsh, Poliçan, Dropull, Kukës, Përmet, kanë raportuar pakësim të popullsisë së shërbyer, për shkak të migrimit të brendshëm të popullsisë, ku ka një përqendrim të shtuar të saj drejt qendrave të mëdha urbane si në Tiranë, Durrës, Vlorë etj.

Gjithsesi rritja e Mbulimit të Furnizimit me Ujë nga shoqëritë UK është e lidhur drejtpërsëdrejti edhe me investimet e nevojshme fizike që kërkohen të kryhen në sektor për të mbuluar të ashtuquajturat "zona të bardha" të pa shërbyera më parë me shërbim të furnizimit me ujë nga shoqëritë UK ekzistuese.

"Mbulimi me Kanalizime" për vitin 2022 ka një përmirësim të dukshëm me rreth me 2.4% krahasuar me vitin 2021 dhe është në nivelin e 54.4 %, pasi popullsia me shërbimin e KUN është rritur me rreth 103,153 banorë. Në sektor janë akoma rreth 78 mijë banorë të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike kundrejt 2.4 milion banorëve që shërbehen nga shoqëria me kanalizime. Zgjidhja me gropa septike është zgjidhje e pranueshme për zona rurale me popullsi relativisht të rrallë, por problem për to mbetet respektimi i kushteve teknike të zbatimit të tyre për të garantuar impaktin negativ që ato mund të japin për ambientin pritës.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 është raportuar edhe një rritje me 22,170 banorë e popullsisë së shërbyer me ITUN krahasuar me vitin 2021 duke e çuar në 678, 860 banorë numrin total të tyre të raportuara nga 7 shoqëri UK.

Rritja e cilësisë së shërbimit të kanalizimeve si dhe përmirësimi i këtij treguesi është i domosdoshëm dhe lidhet me nevojën e investimeve të konsiderueshme që kërkohet të realizohen për këtë qëllim. Niveli i investimeve në drejtim të mbulimit me KUN ka qenë i pamjaftueshëm, duke qenë se investimet janë fokusuar kryesisht në drejtim të mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë.

“Eficienca e Energjisë” është një tregues i vendosur për herë të parë në listën e treguesve kryesorë të performancës në vitin 2022 i përcaktuar në metodologjinë e re të tarifave, si një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK dhe që duhet të monitorohet si nga shoqëria ashtu edhe nga ERRU. Për vitin 2022 eficienca e energjisë për furnizimin me ujë në sektor është 0.69 kwh/m³, por duke qenë viti i parë i vendosjes së këtij treguesi nuk mund të realizohet një analizë krahasimore me vitin e mëparshëm. ERRU, për shoqëritë që kanë aplikuar për tarifa gjatë vitit 2022, ka vendosur detyra mbi domosdoshmërinë e studimit të komponentëve të efijencës së energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN.

Monitorimi i këtij treguesi do të realizohet nëpërmjet variablave :

- Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për furnizim me ujë (konsumi i të gjitha instalimeve teknike – impiante trajtimi, stacione klorinimi, stacione pompimi, hidrofone, rezervuarë, të tjera) në zonën e shërbimit. (Kw)
- Vëllimet e ujit në hyrje të sistemit m³
- Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për trajtimin e ujërave të zeza (konsumi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza) kw
- Vëllimi i Ujërave të zeza të trajtuara në WWTP m³

Nëpërmjet monitorimit të këtyre variablave, ERRU, do të llogarisë 2 tregues performance të efijencës së energjisë, për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura, të cilat duhet të kenë trend rënës për një performancë të mirë. Analiza e këtij treguesi bëhet për shkak se rritja e konsumit të energjisë elektrike është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e kostove operative si me situatën e krizës energjitike globale.

